

Hija e Fajit

(Dramë në gjashtë tablo dhe dy gjysma epilogu)

Vetat:

SAIMIRI
MANI
VJOLLCA
AVNIU
DITA
JERA
FISNIKU
PALI
XHIDJA
ZENELI
ESATI
GENCI
KAMERIERI , etj.

Ngjarja zhvillohet në vitet tetëdhjetë të shekullit njëzet.

Gjysma e parë e epilogut

Mjedis i brendshëm i një apartamenti. Në mesin e dhomës një tavolinë gjysëm e shtruar. Saimiri është me shpinë nga shikuesit dhe po rregullon një tablo në mur. Vjollca hyn nga dhoma tjetër dhe merret me shtrimin e tavolinës. Dëgjohet e qara e një foshnje.

VJOLLCA – Dëgjoje, dëgjoje, Saimir, po qan! A je i lumtur?

SAIMIRI – Nuk ngopem dot nga emocioni, ...

VJOLLCA – Si thua, do të vinë të gjithë?

SAIMIRI – Po, po, rri pa merak, Vjollca! Të gjithë do të vinë, të gjithë...Ke për të parë! Po ti ç'bën, sikur ke humbur fare!

VJOLLCA – Jeta qenka e çuditshme! Njeriu hutohet edhe në gëzime!..

SAIMIRI – *(Spektatorëve)* Thonë, se njerëzit në çaste të lumtura ose rrinë në heshtje, ose s'dinë të ngopen nga lumturia e tyre, ose kanë dëshirë të flasin e të flasin pa mbarim! Kjo e fundit po më ngjet edhe me mua sonte, megjithëse, ata që më njohin mirë, më fusin në mes të atyre tipave, të cilëve mezi ua nxjerr fjalën me grep. E pra,unë, me të vërtetë, ndjehem i lumtur, sepse ditët e fundit jam bërë baba. Por jo thjeshtë për këtë desha t'ju rrëfej jetën time. Ç'është e verteta, jam matur edhe më përpara, por nuk më ka rënë rasti të mblidhen kaq shumë miq në gëzimin tim. Pa dashje ju futa edhe juve në këtë valle, por në gëzime të tilla sikur e ndjen veten të ngrohtë e më të sigurtë, kur ke pranë kaq shumë miq e shokë, të mirë natyrisht! Përse them kështu? Do të keni rastin t'i gjykoni vetë, sepse historia ime është disi e vecantë. Të më falni, nëqoftëse nuk di të tregoj edhe aq bukur, se edhe mund të ngatërrohem në rrjedhën e ngjarjeve. Po le të fillojmë menjëherë... Afro dy vjet më parë u njoha me një vajzë, të cilën e desha shumë. E quanin Jera.

Tabloja e parë

Muzg. Pamja e jashtme e një lokali. Njerëz të ulur. Hyjnë Jera e Saimiri.

JERA – Vetëm unë po flas! Kushedi ç’thua me vete!

SAIMIRI – Them me vete, se ka edhe dërdëllisje të këndshme.

JERA – Vërtetë? Po kështu jam unë, pastaj vetë e ke fajin. Unë s’të detyrova. Ty të ra në kokë dhe m’u ngjite...

SAIMIRI – Po ti pse pranove?

JERA – Lira më theu...

SAIMIRI – Ç’gabim të madh paska bërë! Këtë nuk do t’ia fal!...

JERA – Pse?

SAIMIRI – Se shkesët nuk më kanë pëlqyer kurrë. Edhe Lira ka qënë një biçim shkesi!

JERA – Atë e kam shoqen më të mirë. Bile tani e dua edhe më shumë.

SAIMIRI – Përkundrazi, tani e tutje unë s’do të kem pikë respekti për të.

JERA – Ore, je në vete! (*Pauzë*) E di Saimir, shpesh pyes veten, si ndodhi kështu me mua kaq papritur e nuk e gjej dot përgjigjen. Të vijnë ca ustallarë, që as emrat s’ua di dhe qesh me ta, kur thërresin me gjithë bulçitje “llaç”, ”llaç”. Vetëm një herë ngre kokën për të parë muret e repartit të ri, që po ngrihet dhe befaz sheh dy duar, që nuk lëvizin, sikur të kenë ngrirë, dy sy që të janë mbërthyer pa të lënë mundësi t’u shmangesh dhe një zë që therret “Ej, Saimir, ç’pate!”

SAIMIRI – Pastaj?

JERA – Pastaj...Ndjen ngacmimin e atij vështrimi dhe detyrohesh t’i bësh ballë thumbave të Lirës. Ndonëse e ke inat, që po i jep rast të tallet, të vjen mire, që ia mësove emrin atij, të cilin prej disa ditësh e ke parë nja dy - tri herë ashtu kalimthi... Ca më vonë të ka bërë përshtypje, kur je ndeshur befaz thuajse përballë, në mapo, te rrobaqepësja, apo duke dalë e shkujdesur nga teatri... Mirëpo, kjo nuk paska qënë e rastësi! Ky zbulim i çastit edhe të turbullon, por edhe se ç’ndjen diçka të ngrohtë. Megjithëse kjo kalon lehtë, por ja një ditë një copëz e vogël tulle papritmas të bie të këmbët, si për të të kujtuar, se duhet ngritur koka, sa herë kalon andej. Për një çast mendon, se sinjalin ta ka dërguar ai, por pastaj dëgjon, se atje lart ka plasur një sherr i vogël me dy personat kryesorë, atë që hodhi tullën dhe atë që të mori në mbrojtje e prap të vjen mirë... Dhe kështu, pa e kujtuar, e ndjen, se diçka nga vetja yte ka mbetur atje lart mbi skelë...

SAIMIRI – Pra, nuk paska faj Lira, kot e akuzon...

JERA – Jo, ka faj, se, edhe kur përpiqesha ta harroja, ajo më ngacmonte: “ Shiko, po mbaron repartit! Nuk po ma zë syri atë me flokë te dredhura! Mos është gjë i sëmurë?! I shkreti, ishte edhe simpatik ”! E ku di unë, se çfarë tjetër...

SAIMIRI – Dhe ty të therte në shpirt për këtë dhe e ngrije koken!...

JERA – Po, prandaj...

SAIMIRI – Kurse unë kujtoja, se ti s’mund të kaloje aty pranë, pa e ngritur kokën lart!...(Vjen kamerieri)

JERA – Marrim nga një pastë?

SAIMIRI – Po. (*Kamerieri largohet*)

JERA – Që prej atyre ditëve e ndjeva, se, vërtetë, nuk mund të rrija pa të parë. Zjarrit i hidhte benzinë Lira me ngacmimet e saja. Pastaj një ditë tjetër e bëmë rrugën bashkë dhe ndonëse më fole aq thjeshtë, unë, budallaçka të pranova menjëherë! Më rroftë, që shoqet më quanin ngjalë!

SAIMIRI – Ngjalë?

JERA – Po, më thonin, se nuk zihesha kollaj! Kurse ti... (*Kamerieri sjell porosinë*) Merre me mend, se sa do të çuditet mamaja. Sa herë që trokisnin në portë, kuptohet se për çfarë, kryesisht nusja e dajës ose halla, ua prisja shkurt. Kurse me babin gjithmonë jam marrë vesh më mirë. Ai do të më kuptojë...

SAIMIRI – Po si do t'i thuash?

JERA – Si do t'i them? Nuk e di, nuk e kisha menduar ndonjëherë! Po ja, do t'i shkoj në dhomën e punës dhe do t'i hidhem në qafë. Ai do të ngrëjë kokën e do të më pyesë. Hë, Jera? Me çfarë po na gëzon? Unë do të mbështes kokën në gjoksin e tij. Ai do ta kuptojë. Kush është ai, do të më pyesë. Saimir e quajnë, Saimir Dalipi, do t'i them. Tjetër, do të pyesë ai. E dua shumë, shumë... Këtë e kuptoj, po tjetër? Ashtu siç e ka emrin ashtu është, "sa i mirë". Nuk mund të rri një çast pa të! Tjetër, do të thotë babai. Është i ndershëm, do t'i them, nuk shfrytëzon rastin, është pak i heshtur, ka një zë të butë dhe është punëtori më i mirë i ndërmarjes.

SAIMIRI – Më mburre shumë! Babai do të fillojë të bëjë zbritjet e nevojshme.

JERA – Kështu më kanë thënë.

SAIMIRI – Kush t'i paska thënë këto?

JERA – Ai shoku yt, Pali.

SAIMIRI – Pali?

JERA – Po. Para dy ditësh më ndeshi në rrugë dhe më përshëndeti. Ti më kishe folur për të, prandaj edhe unë ia ktheva përshëndetjen, kurse ai u ndal. Hë, moj kumatë, si je? - më tha. Unë u skuqa. Ai më rrahu krahët dhe qeshi. Pastaj më foli për ty...

SAIMIRI – Vazhdo me babain...

JERA – Babai? Shumë mire, do të thotë. Kështu e kam menduar dhëndrin edhe unë, punëtor e të ndershëm... Po tjetër, do të më pyesë babai. Tjetër, hiç. Ua, vërtetë, ç' do t'i them tjetër? Pse nuk mjaftojnë këto?

SAIMIRI – Mbase nuk mjaftojnë.

Hyn Esat Luka. Saimiri ul kokën.

ESATI – Mirëmbërëma, Saimir!

SAIMIRI – Mirëmbërëma! (*Kamerierit*) A mund të paguajmë (*Paguan*) Ngrihemi ?

JERA – Kaq shpejt?

SAIMIRI – Duhet të ngrihemi, Jera! (*Ngrihen dhe dalin*)

JERA – Kush ishte ai?

SAIMIRI – Dikush që e kisha harruar fare, siç kisha harruar shumë gjëra që lidhen me të. E quajnë Esat Luka.

JERA – Saimir, po ti ç'pate kështu? Je prishur në fytyrë...

SAIMIRI – Sonte mos më pyet për asgjë. Një natë tjetër do të t'i tregoj të gjitha, të gjitha...

JERA – Si të duash. Por ai duhet të jetë njeri i keq, perderisa na e prishi këtë mbrëmje të bukur...

SAIMIRI – Përkundrazi, unë kam gabuar njëherë rëndë me të, sa më vjen zor ta shoh në sy...

JERA – E po mirë, gjëra që ndodhin. (*Sheh orën*) Ua, sa shpejt paska kaluar ora! Ec e duroje mamanë tani. Si thua Miri, të flas me babain sonte?

SAIMIRI – Jo, sonte, jo...

Dritat

Tabloja e dytë

Shtëpia e Avniut. Po ajo natë.

DITA – (*Avniut*) Shko, shko mbyllu në dhomë deri në mesnatë e mos e çaj kokën për asgjë!

AVNIU – Ashtu dukem, por për brenda ziej...

DITA – Kur kazani zjen, derdhet! Kurse ty, as avujt s'po të duken gjëkund.

AVNIU – Këto punë nuk bëhen me të nxehur, se nuk fitojmë gjë. Rëndësi ka të bindet Jera...

DITA – Asaj i duhen shtrënguar vidat, sa t'i kërcasin brinjët, se mjaft ia ke lenë të liruara. Akoma nuk je bindur, zotërote, se rruga e mirëkuptimit tënd të famshëm të çoi në këtë udhë qorre? Dil tani, po munde prej saj.

AVNIU – Nuk duhen humbur shpresat.

DITA – Mjaft ia kemi pirë lëngun besimit tënd deri tani! Çuditem, si nuk më kanë uruar njerëzia! Urime për vajzën, Afërdita! Urime! Na thanë që e kishit fejuar! Pika që s'më bie!..Afërdita e gjorë e merr vesh e fundit...E po, domosdo e padalë!Tërë ditën rri mbyllur në arshivën e ndërmarrjes, pasdreke punët e shtëpisë...

AVNIU – Mos u merr me botën! E rëndësishme është të gjejmë ndonjë rrugëzgjidhje...

DITA – Kush ta gjejë, ti? Ti nuk nxjerr mizën prej qullit! Për ty sikur s'ka ndodhur asgjë! Posi, punët shkojnë vaj!

AVNIU – Nuk duhet të nxitohemi... Përndryshe, në vend që të ndreqim punë, do ta djallosim më keq. Këtu nuk është fjala që po ngulim ose po shkulim një gozhdë...E në qoftëse kjo që ndodhi na erdhi papritur, prapë nuk duhet humbur qetësia. (*Bie zilja. Dita shkon ta hapë*)

GENCI – (*Hyn*) Mirëmbërëma!

DITA – Hajde, urdhëro, Genci! (*Përshëndeten*)

GENCI – Jera nuk qënka në shtëpi?

DITA – Jo, ka shkuar nga halla e vet.

GENCI – Epo mirë, kur të kthehet jepini këtë librin, që ma ka kërkuar.

AVNIU – Gjithmonë me libra ti, Genci. Ke dhënë ndonjë provim?

GENCI – Mbarova vitin e dytë me korespondencë, jam pak i vonuar...

DITA – Ti ke qënë nxënës i shkëlqyer në gjimnaz, përse nuk e vazhdove ditën?

GENCI – Nuk më pëlqeu dega.

DITA – Ndonjë të re për shtëpinë keni?

GENCI – Nuk e di, a e keni parë. Oborin e prishën. Akoma s'na kanë thënë të bëhemi gati, po s'ma ha mëndja të zgjatet shumë.

DITA – Të vjen keq? Goxha shtëpi!

GENCI – Ç'të bësh! Edhe ne si shumica! (*Dita do që t'i hedhë një kupë raki.*) Jo, faleminderit, nuk pi. Më falni, se po ngrihem. Do t'i telefonoj më vonë Jerës. Natën e mirë! (*Del*)

DITA – Eh moj Jera, moj Jera! Kaq kohë që njihesh me goxha djalë dhe vete e më bën dashuriçka me një copë murator...Hapu dhe të futem! Ec e dëgjo tani gojë e botës!

AVNIU – Në daç ta dish, s'më prishet puna fare për gojë e botës,se në fund të fundit, Jera do të fejohej një ditë, me shkuesi a me dashuri. Rëndësi ka për mua përmbajtja, kuptove? Përmbajtja...

DITA – Po të jetë kështu, ti e paske ndarë mendjen. Ne kot grijmë sallatë. Epo, të na trashëgohet vajza, burrë i dashur! Mendimi i gruas nuk të hyn në punë...

AVNIU – Më duket, se deri tash sikur nuk të dhashë ndonjë miratim...

DITA – Kuptohet. Përderisa ty s'të bën përshtypje, që vajza s'të është kthyer akoma në shtëpi, përderisa për ty nuk paska ndonjë rëndësi forma, me dashuri a me shkuesi, përderisa përmbajtja qënka e shëndoshë, meqë ta paskan lavdëruar dhe Vehapi e ndonjë tjetër... E ç'duhet më, për të thënë, se ky është miratimi yt?

AVNIU – Kur nxitohesh dhe flet pa i ditur të gjitha, s'do mend që do të gaboresh...

DITA – Ky është kuptimi i fjalëve të tua.

AVNIU – I atyre që thashë qëparë, por jo i të tjerave, që nuk i kam thënë akoma...

DITA – E çfarë paska tjetër, që s'e dimë?

AVNIU – Dëgjo deri në fund e mos merr zjarr, se ti je edhe gjaknxehët. Ai djali ka një të tanishme si të gjithë ne, mbase do të ketë një të ardhme si të gjithë ne, por ka patur një të kaluar jo si të gjithë ne...

DITA – Kjo na qënka! Miell e krunde përzier bashkë! Nga familja?

AVNIU – Jo. Janë familje e mirë. Ka vetëm nënën dhe një motër. Babai i ka vdekur para pesë vitesh, pikërisht në atë kohë, kur i biri, pra ai, kryente dënimin me heqje lirie.

DITA – (*Kërcen*) Kjo është e tmerrshme! Dhe ti ma zgjat kaq shumë? Pse nuk ma thua copë, po hidhesh degë më degë? Përse nuk më thua, se shtëpisë tonë i qënka vënë damka e zezë? (*Ngrihet*)

AVNIU – Ku shkon?

DITA – Atje, ku duhej të ishe ti në këtë cast.

AVNIU – Mos u nxito, prandaj nuk desha të të thoja, se ti merr flakë si kashta.

DITA – Bota nuk ha bar. Bile çuditem, si s' ma kanë thënë deri tani!

AVNIU – Të thashë, mos na bëj ndonjë veprim të nxituar!

DITA – Nuk të pyes. Do të bredh gjithë qytetin, deri sa t'i gjej. Kurrë nuk do ta lë unë vajzën time në krahët e një ish të burgosuri, sikur tokë e qiell të bëhën bashkë. Dëgjove? Nuk kam vdekur akoma...

AVNIU – (*Shpërthen*) Edhe unë, pra, po të them, se nuk do të kapërcesh këtë prag! Edhe të lutem, mos kërcë kështu, kur të vijë vajza, dëgjove?

DITA – Jo, po do të rri të kënaqem me leksionet e tua...

AVNIU – Në qoftë se ndonjëhere nuk të kam folur kështu, sonte merre si urdhër.

DITA – Mos do të iki fare nga shtëpia të mos ju bezdis?

AVNIU – Jo, por në këto momente nuk duhen acaruar gjakrat. Në qoftëse Jera e di këtë fakt, e megjithatë prapë vazhdon ta dashurojë, që tani po ta them, se do ta kemi tepër të vështirë për t'i ndërruar mendjen. Në të kundërt, them se do të jetë më e lehtë...Dhe vajzës asnjë fjalë, kuptove?

DITA – (*Bie zilja*) Erdhi e 'mira e babait'! (*Ia hap derën*)

JERA – (*E gëzuar*) Mirëmbërëma!

DITA – Ku ishe deri tani?

JERA – Me shoqe...

DITA – Shoqet të përcollën deri këtu? Apo erdhe vetëm?

JERA – (*Me shaka*) Pse të më përcillinin? Nuk më ha njeri! Po ti ç'ke moj mama, unë s'jam kalama!

DITA – Dhe paske të drejtë të vish, kur të shkrepet edhe në mes të natës?

AVNIU – Nuk kemi vajzë të tillë, Afërdita! Kushedi, si e ka pasur punën!

JERA – E di baba, që e shkela sonte, por...

DITA – Çfarë por...?

JERA – Hiç, me shoqet isha...

DITA – Gënjeshtër me bisht!

AVNIU – Dita!

DITA – Ato t'ia shesë tjetërkujt!

AVNIU – Vajza thotë të vërtetën...

JERA – Jo baba, mamaja ka të drejtë... Më erdhi zor, prandaj...

AVNIU – Çfarë, se nuk po marr vesh!...

JERA – E kisha lënë për një natë tjetër, po...

DITA – Mos e tjerr më, po nxirre!

JERA – Mirë, moj mama, do t'ua them. Po ti mos rri ashtu me inat, sikur kam bërë ndonjë krim.

DITA – Krimet dhe gjykatat mos na i zër me gojë, lërvua të tjerëve, atyre që...

AVNIU – (*E ndërpret*) Dita! Vajza sikur deshi të na thotë diçka, apo jo Jera?

JERA – Po, si t'jua them... E kisha menduar disi më të lehtë, kur të vinte një çast i tillë, që t'jua hapja zemrën... Unë... baba, dua një djalë!

DITA – E po, shyqyr, shpëtove tani! Besoj, se edhe u lirove!

JERA – (*E prerë*) Nuk nxora ndonjë gjë të ligë nga shpirti, që të lirohesh dhe, të lutem, mos më fyej! Ky është një çast shumë i bukur në jetë, mama! E kisha të vështirë t'jua them nga respekti dhe dashuria, që kam për ju, njerëzit e mi më të shtrenjtë. Kisha menduar, se kjo e papritur do t'ju prekte, do t'ju gëzonte dhe jo t'ju lëndonte...

DITA – I bukur respekt për prindërit!

JERA – Nuk kuptoj asgjë... Ç'është gjithë ky mllef, që të zien përbrënda, mama? Unë e mendoja, se kjo do ishte një e papritur e këndshme për ju, por, me sa shihet, kjo s'qenka as e papritur e as e këndshme...

DITA – Të dalësh e të bredhësh rrugëve me djalin e botës, që deri para pak kohëve as të ka shkuar në mëndje, se merrte frymë diku në këtë rruzull, pa ditur asgjë për të, kjo është të vesh duart në kokë...

JERA – Nuk kemi dalë skutave e as e kemi fshehur dashurinë tonë, sepse ka qenë e pastër dhe e singertë.

DITA – Atë do ta shohim...

JERA – Më mirë se kushdo tjetër, atë e ndiej unë.

AVNIU – (*Ditës*) I harxhove të gjithë fishekët?

DITA – Kam edhe të tjerë, mos u merakos ti!

JERA – Harxhoji, mama, harxhoji, që të mos mbetet peng. Thuaj, se i kam rënë të mirës me shkelm, kur ua kam kthyer dorën këtij apo atij, se njëri kishte punë të mirë e tjetri do të më mbantë në pëllëmbë të dorës... Se do të na mërzhiten shkesët, që herë quhen nuse daje e herë hallë...

DITA – (*Avniut*) E dëgjon kanarinën tënde, sa bukur këndon?

AVNIU – Dita, kur ta shikosh ti të arsyeshme të më lëshosh radhë, më thuaj, se po pres.

DITA – Këtu s'ka punë radhe. Ç'kishe për t'i thënë, thuaja!

AVNIU – Jo, jo, se po të flasim kështu qit e prit, deri në mesnatë nuk do të marrim vesh asgjë dhe nuk do të fillojmë nga "zh" - ja, siç bëre ti, por nga "a"-ja. Si thua, Jera?

JERA – Po, baba.

AVNIU – Atëherë, po të dëgjojmë.

JERA – Po si të them, a nuk do ishte më mirë të më pyesje ti, baba?

AVNIU – Na fol për atë djalë...

JERA – Ai është shumë i mirë, baba!

AVNIU – Një fjalë goje.

JERA – E them me bindje...

AVNIU – Mos u ngut. Nganjëherë një mënyrë të ecuri, apo një trup i bukur, ca flokë të dredhur, apo një e folur e veçantë, të bëjnë të harrosh brendinë.

JERA – Ke të drejtë, baba. Kështu është. Po unë shpesh pyes veten, ç’që ajo forcë, që, sa herë e shikoja atë, më bënte të mos më hiqej nga mëndja. Mbase fillimisht, edhe mund të jetë bërë shkak ndonjëra nga ato cilësitë, që sapo the, apo, mbase, të tëra së bashku, sepse çuditërisht ti ia vizatove portretin e jashtëm, thua, se ka kohë, që njihesh me të... Por nuk janë vetëm këto, baba... Kam njohur edhe më parë djem, ndofta edhe më të pashëm, por asnjeri s’më ka hyrë në zemër. Asgjë nuk më duket e shtirur tek ai.

DITA – Ec e nxirre tani po munde! Nuk e shikon sa thellë është zhytur?

JERA – Në ujë të pastër, mama...

DITA – Në ujë të fëlliqur!

JERA – (*Me revoltë*) Mama! Si flet kështu për atë?..

DITA – Thashë, atë që është.

JERA – Jo, jo gaboresh. Nuk është ashtu. Saimiri është njeri shumë i mirë!

AVNIU – Gjykimi për tjetrin është gjithmonë më i saktë, kur e sheh me sy të ftohtë, jashtë zjarrit të ndjenjës.

JERA – Jam e bindur në atë që them, baba!

AVNIU – Ke arritur ta njohësh aq mirë atë djalë, sa ta quash shok jete?

JERA – Ndryshe nuk do t’jua zija në gojë...

AVNIU – Je në gjendje të flasësh për të me hollësi?

JERA – Gjithë ditën e gjithë natën.

AVNIU – Hë pra, po presim.

JERA – E quajnë Saimir Dalipi. Është njëzet e gjashtë vjeç dhe punon në ndërmarrjen e ndërtimit, si murator me kategorinë e pestë. Është punëtori më i mirë i brigadës. Këtë nuk po e them unë, por shokët e tij, të cilët lënë kokën pas tij. Është tip i heshtur e shumë i ndjeshëm. Është i thjeshtë dhe i sinqertë. Por, ajo që ka më shumë rëndësi, më do shumë. Besoj, se mjaftojnë këto apo jo?

AVNIU – Kanë rëndësinë e vet, por s’janë gjithçka...

JERA – Në shtëpi ka nënën dhe një motër me të cilën është shumë i lidhur. Babai i ka vdekur para tetë vjetësh. Ai preket shumë, kur flet për të atin. Duhet ta ketë dashur së tepërmi... Ç’të them tjetër?

AVNIU – Përderisa nuk ke, kjo do të thotë, se kaq është shkalla e njohjes.

JERA – Mendon, se gaboj në njohjen time, baba?

AVNIU – E vë në dyshim...

JERA – Pra, paske humbur besimin tek unë?

AVNIU – Jo, besoj në ato që thua, por njohja është e cekët, nuk ke shkuar gjer në fund...

JERA – Nuk kuptoj.

AVNIU – Ke të drejtë. Po ti si thua, ne që jemi prindët e tu, a mendojmë vetëm për të mirën tënde?

JERA – Nuk e vë në dyshim.

AVNIU – E pra, mendimi ynë është, se ti je ngutur.

JERA – E përse baba? Ç’ka ndodhur?

AVNIU – Ai nuk është treguar i sinqertë me ty, Jera!

JERA – Nuk është e mundur...

AVNIU – Po bija ime, për fat të keq, kështu është. Ti nuk i di të gjitha, sepse, para se të lidheshe, ti nuk je interesuar mirë për të, as më vonë nuk ke pyetur, se cila ka qenë rruga e tij në jetë, a ka pasur ndonjëherë kthesa jo të këndëshme dhe pse. Ti nuk e ke pyetur dhe as që të ka shkuar ndonjëherë ne mendje të pyesësh, sepse i ke besuar. Por ai, për të merituar ato fjalë që ti thua për të, duhej ta kishte hapur zemrën qysh në fillim. Atëherë edhe mund të flisnim për sinqeritet e ndjenjë të dliërë. Edhe qëndrimi ynë, mbase, do të ishte ndryshe...

JERA – Si është puna baba?

AVNIU – Para tetë vjetësh ai ka qënë i denuar me heqje lirie!

JERA – Jo, jo nuk mund të jetë e vërtetë, nuk është e vërtetë!

AVNIU – Po, bija ime. Me keqardhje dhe dhimbje po ta them, është e vërtetë!

Jera mbulon fytyrën me duar e qan me dënesë.

Dritat

Tabloja e tretë

Dekori i tablosë së parë. Saimiri është i ndalur në të djathtë, ku gjendet një kabinë telefonike. Pranë është klubi. Merr dorezën dhe i bie numrit.

ZËRI – Alo! Urdhëroni!

SAIMIRI – Familja Abazi? Alo! Jera, ti je?

ZËRI – Jo, jam e ëma. Jera nuk është në shtëpi...

SAIMIRI – Ashtu?

ZËRI – Më falni, po ju kush jeni?

SAIMIRI – Saimiri. I thoni, kur të vijë, se telefonoi Saimiri. Unë mendoja, se mos ishte e sëmurë...

ZËRI – Po ju, mos jeni gjë mjek?

SAIMIRI – Më keqkuptuat. Unë jam një shok i saj.

ZËRI – Shikoni, mos i keni rënë numrit gabim. Ajo nuk ka ndonjë shok me emër të tillë.

SAIMIRI – Ju, mbase, nuk e dini...

ZËRI – (*E ndërpret*) Këtu s'ka asgjë për të ditur dhe, ju lutem, të mos na shqetësoni më... E në do, ta them troç, ty asgjë nuk të lidh me Jerën! Më kupton, asgjë! Lëreni rehat në punët e saj e mos e merrni në qafë!

SAIMIRI – Më falni nuk po kuptoj, mos ka ndonjë keqkuptim?

ZËRI – Më duket, se fola qartë. Dhe ky nuk është mendimi im, por i Jerës...

SAIMIRI – I Jerës? Po ajo, pse nuk ma thotë vetë?

ZËRI – Sepse nuk do ta shohë më me sy, atë që e zhgënjeu keqas! E morët vesh tani? Dhe ju, do të kishit bërë shumë mirë që në të ardhmen, përpara se të kërkonit fjalën e një vajze, të tregoni të vërtetën për të kaluarën tuaj! Kuptuat tani? Vagabond! Maskara!

SAIMIRI – (*I dërmuar*) Përse kështu, përse?!

Ul dorezën e telefonit. Me kokën e varur shkon e ulet në klub. Kamareieri i sjell një dopio konjak. Fillon ta pijë. Merr gotën e dytë, por në çastin, që do ta çojë hyn Pali, që i vë dorën në gotë.

PALI – Po ti, ç'bën kështu? Më ranë këmbët duke të kërkuar. Isha edhe në shtëpi...

SAIMIRI – Ulu, Pal!

PALI – Po ulem, po nuk do të rri shumë, nuk e kam mirë Suelën...

SAIMIRI – (*Si i humbur*) Pse?

PALI – Ku ta di unë, më duket se bajamet! Po ty ç'të paska shkrepur sonte, që të pish? Ti sikur nuk e ke vënë në buzë! Apo ke ndonjë sebep, kështu? Të paktën, të ma kishe thënë edhe mua, jo kështu fshehurazi...

SAIMIRI – Fshehurazi?

PALI – Mirë, e thashë, se kështu nuk bëjnë shokët! E di, me kë isha në shtëpinë tënde?

SAIMIRI – Jo...

PALI – Me një shokun tënd të fëmijërisë. Nëna u gëzua shumë, kur e pa. Dolëm bashkë për të të kërkuar, po pastaj u ndamë.

SAIMIRI – Kush ishte ai?

PALI – Ta thotë nëna ose, po pate durim deri nesër, e takon vetë. Ka ardhur të bëjë punën fizike në brigadën tonë... Erdhi sot në drekë, sapo ike ti. U habit dhe u gëzua njëkohësisht, kur mori vesh se ti punoje aty. Se si ra ashtu muhabeti... Po he, e takove Jerën?

SAIMIRI – Jo...

PALI – I gjori ti! Katër ditë pa e parë. Kjo është e tmerrshme! Prandaj po pin zotrote? Forca, jepi! Me fund, se kështu bëjnë burrat e vertetë!

SAIMIRI – Merre edhe ti një gotë, Pal! Mos ma prish!

PALI – Po e marr. Po ti sikur më kishe thënë, se ke harruar të pish. Ka tetë vjet, që s’e ke afruar te buzët. Apo jo?

SAIMIRI – Nuk kisha harruar të pi, kisha vendosur.

PALI – S’qënke burrë, që e mbake fjalën!

SAIMIRI – Ndonjëherë edhe më falet, o Pal...

PALI – Po, edhe unë po ta fal, atëherë! Kamerier! Një teke! Më thuaj tashti, si është puna?

SAIMIRI – Sa vjet ke, që më njeh?

PALI – Që para gjashtë vitesh, kur erdhe në brigadë. Sapo ishe liruar nga ushtria. Akoma s’të ishin rritur mirë flokët...

SAIMIRI – Po pse u miqësove me mua?

PALI – Ama pyetje!

SAIMIRI – Pse s’ma thua troç, se më kishe marrë në patronazh, se kishe frikë, mos shkisja prapë?

PALI – Sonte qënke i çuditshëm!

SAIMIRI – Jo, Pal. Kjo nuk shumë e vështirë për t’u marrë vesh...Unë bëja, sikur nuk kuptoja, se më pëlqente shoqëria me ty. E ndjeja veten më mirë me shokë si ti...

PALI – Ditke të bësh edhe komplimente?

SAIMIRI – Nuk e kupton, se sonte paskam nevojë të rrëfhem?

PALI – E përse? Mua më pëlqen shoqëria me ty dhe anasjelltas. Barabar kjo punë...

SAIMIRI – Jo, nuk është barabar. Pak më parë më përmende flokët...Është e vërtetë, se i kam merak ato qysh nga fëmijëria. Po edhe ti, edhe të tjerë, keni qënë ushtarë e i keni qethur.

PALI – Po pra, njëlloj si ti.

SAIMIRI – Jo, ndryshon! (*Me mlllef, duke i theksuar fjalët*). Unë i kam qethur dy herë flokët. E more vesh? Një herë përpara, se të shkoja ushtar...

PALI – E ç’e zë në gojë! Nuk e paske harruar ende?

SAIMIRI – E kisha fshirë nga kujtesa, si diçka që nuk më përkiste mua, si diçka të huaj, të vdekur njëherë e përgjithmonë; e kisha groposur dhjetë pash nën dhe, po ajo ngriti krye, kur nuk e prisja...

PALI – Nuk e kuptoj...

SAIMIRI – Çfarë është hija, Pal? A nuk është diçka e errët, me fare pak dritë, pas një arre, një lisi, një shtëpie, një njeriu? A nuk është një njollë e madhe apo e vogël sipas rastit, që disi të pengon dritën? Po hije paska edhe faji, o Pal, faji që ke bërë dikur dhe që ti ke kohë, që e ke harruar. Ardhka një ditë, që ajo befas ngre kokën për të të penguar dritën, pikërisht atëherë, kur ti kërkon vetëm dritë... (*Ngre kokën lart*)

PALI – Ashtu të kërkosh, vetëm dritë...

SAIMIRI – Po pra, por më pengon hija! Ajo s’pyet për asgjë, ajo të breka pa mëshirë, ajo të kafshoka shpirtin dhe ky qenka ndëshkimi më i madh që merrka njeriu nga faji. Fajin nuk e shfajëson asgjë. Ai është faj... Faj!

PALI – Saimir, ti s’më ke folur ndonjëherë kështu! Ç’paska ngjarë me ty? Po bëjmë kaq vite bashkë, por unë asnjëherë nuk të kam pyetur... Diçka kisha dëgjuar ashtu kalimthi, po ç’rëndësi ka, kur tek ti s’kishte mbetur asnjë gjurmë e vogël e asaj, që thuhej për ty. Është e vërtetë, se në fillim t’u afrova për të të mbajtur pranë, por vetëm në fillim ama, se pastaj e kuptova, që s’mund të rrija pa ty e këtë ta them me gjithë zemër, jo thjeshtë për të qetësuar shpirtin tënd, që sonte qënka i turbulluar keqas.

SAIMIRI – Mos ma vër re sonte, Pal... Me siguri, nesër do të jem ndryshe. Kam forcë... Po, sonte, jo. Sonte kam ngrënë grushtin më të rëndë në jetë!..

PALI – Fol pra, ta marrë djalli, ç'ka ngjarë?

SAIMIRI – Përmende djallin, Pal? E pra, sonte kam dëgjuar zërin e djallit! Ai më bëri të pi. Kisha harruar të pi. Po djalli më fyu rëndë....

PALI – Lëri filozofitë e fol troç!

SAIMIRI – Sonte do të më falësh për gjithçka, edhe po thashë ndonjë budallallëk...

PALI – E mirë, mirë!

SAIMIRI – Kush e ka shpikur telefonin, Pal, e di ti?

PALI – Prapë me të tuat?

SAIMIRI – Përgjigju!

PALI – Nuk e di.

SAIMIRI – As unë. Di vetëm, që është një aparat me një dorezë e ca numra, përmes të cilit mund të flasësh e të dëgjosh... E pra, s'ka shumë që nga ky aparat dëgjova zërin e djallit! E kupton tani?

PALI – More, me cilin ke folur?

SAIMIRI – Të thashë, pra, me djallin, se njeriu nuk mund të të fyejë ashtu! Tjetrit edhe mund t'i largohesh, t'i shmangesh, t'i nxjerrësh një mijë e një shkaqe, por jo t'i hapësh një plagë, që e mendonte të përtharë...

PALI – Të lutem Saimir, mos më bëj nervoz, më thuaj, pash gjënë që ke më të shtrenjtë, me cilin je zënë? Me Jerën?

SAIMIRI – Këtë emër harroje, Pal, harroje!

PALI – Si ta harroj, kur ti ma ke përmendur më shumë se pesëdhjetë herë në ditë?

SAIMIRI – Edhe unë do të përpiqem ta harroj, sepse duhet... Ajo nuk ka faj. Askush nuk ka faj, përveç meje. Në fund të fundit, përse duhet, që ajo të lidhë jetën me një ish të dënuar si unë?

PALI – More, je në vetë apo jo? E di, se ç'flet?

SAIMIRI – Vërtetë kam pirë, por nuk jam i dehur. Çuditërisht!

PALI – Mirë, mirë, e shoh, se është e kotë të flasim sonte. Ngrihu tani!

SAIMIRI – Shko ti, se ke vajzën e sëmurë...

PALI – Nuk luaj këmbë pa ty, jo se nuk kam besim, por se çdo gjë ka karar. Pive mjaft, për të shfryer, shfreve, eja tani, se edhe nëna mërzitet...

SAIMIRI – Më gjete pikën e dobët, o Pal... Më përmende nënën. Po ti, pa dashur, ma shtove helmin...

PALI – Më fal, nuk desha, megjithëse nuk e di, se për çfarë...

SAIMIRI – Më kujtove babain...

PALI – Kujtimi për një baba të mirë duhet ta heqë helmin.

SAIMIRI – Jo, vëlla, varet, se kush kujton. Për atë unë kam qenë një djalë i keq. Dhe ka pasur të drejtë, se unë e kam futur në dhe. E merr vesh ti? Unë me duart e mia!

PALI – Me sa kam dëgjuar, ai ka qenë i sëmurë.

SAIMIRI – Sëmundja përmirësohet, kur gjen mjedis të mirë, ose përkeqsohet në të kundërt. Për një njeri të ndershëm si ai, budallallëqet e mia ia shkurtonin jetën. Nuk mund ta harroj atë fytyrën e tij të zbehtë, atë zërin e ulët nëpër shtëpi, thua se kishte frikë se mos zgjonte njeri nga gjumi, atë vështrimin e butë që ia falte kujtdo, atë të ecurën e avashtë, sikur druhej, mos i rëndonte tokës... Vetëm një herë e kam parë të nxehur, vetëm një herë! Eh...ka qenë një natë e keqe! Binte shi i dendur dhe qielli gati sa s'çahaj nga vetëtimat. Ishte vonë, po unë bridhja, bridhja pa ditur se ç'bëja. Me mua ishte edhe "ai". Nuk dua t'ia përmend emrin, se më nxiu jetën...Po fajin kryesor e pata vetë. Shkollën e kisha lënë. Punës i bëja bisht dhe u njoha me të... Isha tetëmbëdhjetë vjeç. Nuk isha kalama nga mosha, por nga trutë. Ai më futi

në klub të pinim. Ishte hera e dytë apo e tretë. Ja zëre, se ishim në këtë klub. Ja, ai rrinte përballë meje, kështu, si ti... Pimë shumë...

Errësohen dritat. Koha është e keqe. Në po atë tavolinë vendin e Palit e ka zënë Zeneli.

KAMERIERI – Ju lutem llogarinë.

ZENELI – Dëgjovë, Saimir? Dashka të na përcjellë! Ik , mor spurdhjak, na lër në qejfin tonë!

KAMERIERI – Ju lutem, u bë vonë. Ka kaluar ora, nuk e shikoni, që vetëm ju keni mbetur?

SAIMIRI – Ngrihemi, Zenel! Më vjen për të vjellë...

ZENELI – Nuk ke faj, je qumështor... Kështu e ka fillimi! *(I drejtohet kamerierit)* Edhe nga një teke!

KAMERIERI – Nuk mund t'ju shërbej më!

ZENELI – Deri në mëngjez, po të dua unë.

KAMERIERI – As edhe një minutë më tepër. Llogarinë, ju lutem!

ZENELI – *(Nxjerr nje shuk parash)* Ja, merr sa të duash e mos na çaj derrasa më!

KAMERIERI – Ju keni për të paguar vetëm njëzet e gjashtë lekë e dyzet qindarka... *(Zeneli bëhet gati të thotë diçka, po Saimiri ka parë të jatit e ngrihet.)*

SAIMIRI – Baba!

MANI – *(I afrohet ngadalë)* Mirëmbërëma!

ZENELI – Hajde, babush, ulu! *(Kamerierit)* Ç'pret? Një dopjo babushit!

MANI – Të faleminderit, or mik, unë nuk pi!...

SAIMIRI – Po ti, baba, pse dole në një kohë të tillë? Je bërë qull...

MANI – Thahem prapë. Do të pish më?

SAIMIRI – Ja, po vij! Zenel, po shkoj me babain! Ç' rastësi, që hyre këtu! Ti nuk kishe dalë për mua, apo jo?

MANI – *(Të birit)* Ke gjë për të paguar?

ZENELI – Nuk paguan njeri, kur është me mua, babush! Aq më tepër babai i Saimirit, që e kam si vëlla të vogël.

MANI – Ty t'u rritë ndera, po edhe i vogli, kur bëhet për të zënë tavolinën, duhet të fusë dorën në xhep, përndryshe i mbetet shumë borxh tjetrit...

ZENELI – Le të më nxjerrë ndonjë dopio, kur të hyjë në punë. Tani..

MANI – Tani paguaj unë për të! *(Kamerierit)* Sa bëjnë?

KAMERIERI – Njëzet e gjashtë lekë e dyzet qindarka. *(Mani paguan)*

ZENELI – Më fyeve rëndë sonte, o babush, por s'po ta marr për të keq, se je më i vjetër dhe, aq më tepër, babai i Saimirit. Nejsë. Natën e mire!

SAIMIRI – *(Jashtë bie shi i dendur)* Të presim nën strehë, sa të pushojë pak! *(Mani nuk i kthen përgjigje)* Baba, si thua, a presim dhjetë minuta?

MANI – Mos do të marrë rrugët edhe jot ëmë për të na kërkuar?

SAIMIRI – Edhe ti kot dole... Unë s'jam fëmijë...

MANI – Po, po m'u bëre burrë! Bile nga ato, që i mbyllin klubet...

SAIMIRI – Njëherë qe...

MANI – Jo, disa herë. Pastaj një herë bëhet edhe e keqja...

SAIMIRI – Kot shqetësohesh! *(Manin e zë kolla)* E shikon, qe të kapi?

MANI – Lëshomë, se të dridhen duart! Edhe goja të qelbet nga alkooli.

SAIMIRI – Nuk jam i dehur..

MANI – Më keq je, më keq.

SAIMIRI – Po unë s'bëra ndonjë gjë.

MANI – Po do të bësh atë, që nuk e kam menduar kurrë, kështu siç ja ke nisur!..

SAIMIRI – Jo, baba!

MANI – Do të më përcjellësh me faqe të nxirë e me emër të përlyer... Po më mirë, mos e arritsha atë ditë! Dhe m'i thua vetes burrë! Ti je kalama! Kalama!

SAIMIRI – Baba!

MANI – Akoma s'e paske kuptuar këtë? Merre vesh sonte, pra, kush je ti... Ta them unë, unë që të kam dhënë jetën, që të kam ushqyer e po të ushqej akoma si fëmijë...

SAIMIRI – Të dhimbset buka, që më jep, baba? Pse ma përmend?

MANI – Sepse e quan veten burrë. Burrat e fitojnë bukën vetë. Kurse ti, posi, je burrë për të lënë zemëngrirë atë të shkretën atje dhe këtë dorëcungun këtu, që bredh nëpër shi si i marrë. Po, po një dorëcung jam, se nuk kam krahë! Kisha menduar, se po më bëhet krah im bir, se po ma lehtësonte pak barrën, që më ra pa dashjen time, kur i gëzohesha jetës, që më kishte marrë për mbarë asaj jetës së ndershme ngritur me djersën e ballit. Kurse im bir më bredh kafe më kafe, pa çarë kokë për asgjë, pa pyetur, se janë diku ca njerëz, që presin me gjak të prishur, nga bredh dhe ç'bën pjella e tyre...

SAIMIRI – Ke të drejtë baba, e prisha, nuk e mora vesh, se si shkoi ora ashtu! Po ti rri pa merak, se nuk shkas kollaj në dërrasë të kalbur...

MANI – S'është e thënë ta shohësh me sy coftinën, se era prej saj ndihet nga larg. Prit, kur të përplasesh ndonjë ditë me të... Ti bëj si të duash, se unë nuk kam më fuqi të të ndjek pas, por, në qoftëse do të më njohësh për baba, mos u shoqëro me njerëz të tillë. Nuk e njoh, por se si m'u duk, nuk më pëlqeu... Ti je pa punë, s'ke para. Si ulesh në tavolinë pa një lek në xhep? Aaa, ka ai!... Po pse paguan për ty? Ku do të dalë ai? Ku do të të fusë? Mos bir, mos ec nëpër këtë rrugë të errët. Mos na vër njollë!

SAIMIRI – Baba!

MANI – Nuk dua asnjë fjalë, por këto që të thashë, va ri vath në vesh!

Dritat

Tabloja e katërt

Pamje e pjesëshme e një godine, që ndërtohet.

SAIMIRI – *(Fisnikut)* U lodhe?

FISNIKU – Pse, të gënjej!

SAIMIRI – Nuk do ta kesh të lehtë...

FISNIKU – E di, asgjë nuk është e lehtë në fillim.

SAIMIRI – Po, po, njeriu është i fortë... Përshtatet gjithësesi. Përse nuk kërkove të punoje në një vend tjetër?

FISNIKU – Nuk të pëlqen që jemi bashkë?

SAIMIRI – E kam për ty..

FISNIKU – Do të mësohem, rri pa merak! Po ju, që punoni gjithmonë këtu?

SAIMIRI – Jemi ndryshe...

FISNIKU – Gabohesh, le pastaj, që nuk më bën keq, se kam vënë ca dhjamë...

SAIMIRI – Puna e mbyllur të lodh...

FISNIKU – Vërtetë, kur kthehem në shtëpi tani, më dhembin krahët shumë, por e ndiej veten krejt të qetë. E di, Saimir, sa më ka marrë malli të luaj futboll si dikur, kur harroheshim me orë të tëra tek fusha e vjetër. E mban mend?

SAIMIRI – Luaje bukur...

FISNIKU – Jo si ti. Të gjithë mendonim, se do të bëheshe futbollist. Si thua, a mblidhemi ndonjë ditë? Ç'më shikon ashtu? Të vjen çudi? Ç'po mendon?

SAIMIRI – Sa e çuditshme është jeta!

FISNIKU – Prandaj është e bukur...

SAIMIRI – Kur e ndërton bukur...

FISNIKU – Por, ama, ajo është e gjatë, që të kesh mundësi të bësh ndonjë korigjim të vogël. Sa më shpejt ta bësh, aq më mirë. *(Ndrron bisedë)* Më duket, se në brigadë shkoni mirë më njëri tjetrin.

SAIMIRI – Po.

FISNIKU – A nuk është kjo merita e Palit?

SAIMIRI – Ai ha bukë veç...

FISNIKU – Ashtu mendoj edhe unë. Një drejtues i mirë di të formojë edhe një kolektiv të mire.

SAIMIRI – Palit i detyrohem shumë...

FISNIKU – Në rradhë të parë vetes tënde.

SAIMIRI – Edhe Palit...

PALI – *(Që ka hyrë)* Nuk është mirë të marrësh tjetrin nëpër gojë prapa krahëve!..

FISNIKU – Po më thoshte, se Palit nuk i pëlqen peshku!

PALI – Ah, ma ditke pikën e dobët... S'e kam futur në gojë, që para katërbëdhjetë orësh! *(Shokëve)* Afrohuni! E dini, si është puna? Ka një kërkesë urgjente për disa muratorë për urën e re të hekurudhës. Drejtorja e ndërmarrjes ka mendimin, që të mos shkojë një brigadë e veçantë, por nga dy vetë për brigadë, me që është fjala vetëm për pesëmbëdhjetë ditë. Dakord jeni për këtë? *(Ata miratojnë)* Që të mos e zgjasim, kam mendimin, se këtë herë duhet të shkojë Mensuri me Zefin. Nisja bëhet sot në orën katër.

SAIMIRI – Shkoj unë.

PALI – S'ka pak që u ktheve.

SAIMIRI – Pesëmbëdhjetë ditë janë...

PALI – Ti, jo!

SAIMIRI – Pal, mos kundërshto!

PALI – Mos e zgjat. Ti nuk ke për të shkuar...

SAIMIRI – Duhet, Pal, duhet...

PALI – Nuk e kupton, se...

SAIMIRI – Kuptoj, që duhet të nisem.

Ngjitet në ndërtesë. Të tjerët largohen.

FISNIKU – Është bërë i mrekullueshëm, Pal, apo jo? (*Pali tund kokën*) Jam i bindur se, për shokun ai do të bënte shumë më tepër se kaq. Si të kam thënë, me Saimirin kemi qenë shokë lagjeje. Vërtetë ishte dy tre vjet më i vogël se ne, po e mbanim afër, se luante futboll shumë mirë. Pastaj na ndau shkolla e veçanërisht shtëpia e re, që morëm në lagjen, ku banoj edhe sot. Pas aq kohësh, që s'e kisha parë, nuk ma kishte marrë mendja kurrë, se do të takohesha me të në rrethana krejt të pa dëshirueshme. Kjo ndodhi para tetë vitesh. Sapo kisha mbaruar shkollën dhe ishte ndër proceset e para hetimore, që më besohej...

Shuhen dritat. Kur ndizen jemi në zyrën e hetuesisë diku në paraskenë. Fisniku rri ulur pranë një tavoline pune. Përballë tij është ulur Saimiri.

FISNIKU – Si thua, Saimir, fillojmë? Këtë javë nuk të kam marrë në pyetje, që të kishe mundësi të reagoje drejtë, pas atij qëndrimi aspak të mirë në seancën e parë, që, të them të drejtën, nuk arrij ta kuptoj.

SAIMIRI – Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

FISNIKU – Saimir, nuk e kupton, se po thellohesh në gabim?

SAIMIRI – Ç'kërkon më tepër? Unë e pranova fajin qysh herën e parë... Jepi fund një herë e mirë!

FISNIKU – Do t'i japim, por kur të vijë koha dhe të gjitha gjërat të jenë në vendin e tyre. Tani për tani, sapo kemi filluar dhe, biles, e kemi nisur keq. Do një cigare? (*Saimiri refuzon*). Kur më ngarkuan në hetimin e këtij procesi dhe ndesha në emrin tënd, të them të drejtën, u befasova, se nuk më kishte shkuar kurrë në mendje, se një ditë pas kaq kohësh, që nuk ishim parë, do të takoheshim në këto rrethana... Dhe e di ç'bëra? I kërkova kryetarit të ngarkonte një shok tjetër, i thashë arsyet, i tregova, se kishim luajtur bashkë në një rrugicë, se kishim ngrënë sa herë bukë në shtëpinë e njëri - tjetrit dhe do ta kisha të vështirë të shkëputesha nga ato kujtime të bukura të fëmijërisë, por ai më tha, se kështu do të ishte më mirë, do të kuptoheshim më mirë...

SAIMIRI – Më mirë do ishte, po ta kishte miratuar kërkesën...

FISNIKU – Edhe ti ke këtë mendim?

SAIMIRI – Po, se edhe unë me një tjetër do ta kisha më të lehtë...

FISNIKU – Megjithatë, i kemi hyrë valles dhe s'bën ta lëmë në mes. Por e kishim fjalën tek kujtimet...

SAIMIRI – E ç'vlejnë tani?

FISNIKU – Të kujtojnë, se kush ke qënë...

SAIMIRI – Pak rëndësi ka, tani jam ky që jam, që rri para teje si një i pandehur, që s'ka e s'do të ketë kurrë guximin të të shohë në sy. Në mes kemi një hendek të madh e të thellë. Unë jam një hiç, ti je gjithçka. Prandaj harroji të gjitha dhe kryej detyrën... Nuk ke përse e zgjat më... Ku duhet të firmos që e pranoj fajin? Ç' të duhet më tepër për t'i dhënë fund këtij procesi?

FISNIKU – Duhet ajo që mungon, e vërteta! Si thua, ta nxjerrim bashkë në dritë? Nuk e kuptoj, përse e braktise shkollën në maturë?

SAIMIRI – Nuk e haja matematikën...

FISNIKU – Po pastaj?

SAIMIRI – Hiç, prisja të hyja në punë.

FISNIKU – Ata të lagjes kanë dëshmuar, se të kanë afruar dy- tre vende pune..

SAIMIRI – Kërkoja ndonjë vend më të mire..

FISNIKU – Dhe ndërkohë silleshe kot e bridhje?

SAIMIRI – Bridhja...

FISNIKU – Në ç'rrethana u njohe me Zenelin?

SAIMIRI – Në Pallatin e Sportit, i kishim vendet pranë...

FISNIKU – Pastaj, me siguri, jeni përshëndetur me njëri tjetrin, kur jeni parë rastësisht në rrugë, apo jo? (*Ai miraton*) Këtë miqësi më vonë e përforcuan edhe gotat e konjakut... Po interesant, ç'arsye kishte ai të shoqërohej me një djalë si ti, kur për vete ishte baba fëmijësh, edhe nja dhjetë-pesëmbëdhjetë vjet më i madh se ti?

SAIMIRI – Nuk e di..

FISNIKU – Po ti, nuk ia bëje vetes ndonjëherë një pyetje të tillë?

SAIMIRI – Jo, se nuk shihja asgjë të keqe në këtë mes, i papunë isha...

FISNIKU – Kurse ai xhepin plot...

SAIMIRI – Edhe unë kam paguar ndonjëherë, se më vinte zor.

FISNIKU – Me sa kam marrë vesh, një herë ka paguar edhe babai yt...

SAIMIRI – (*Reagon*) E paske takuar? Si është?

FISNIKU – Helm!

SAIMIRI – E kam të qartë. (*Zë kokën me duar*)

FISNIKU – Edhe atë natë kishe pirë, apo jo?

SAIMIRI – Po...

FISNIKU – Dolët nga klubi dhe u nisët në shtëpi. Pastaj?

SAIMIRI – Pastaj ndodhi ajo, që ndodhi...

FISNIKU – Çfarë?

SAIMIRI – Po ja pra, të thashë një herë. Pashë atë. Para disa ditësh më kishte ngacmuar motrën! Ai më ndaloi, po unë isha i nxehur. I thashë se nuk ishte burrë dhe iu afrova. E godita disa herë me një dorezë hekuri. Pastaj ikëm me vrap...

FISNIKU – Me cilin ishe?

SAIMIRI – Me Zenelin.

FISNIKU – Ku e more dorezën?

SAIMIRI – E kisha gjetur një ditë në rrugë...

FISNIKU – Po Zeneli e qëllloi?

SAIMIRI – Jo.

FISNIKU – Kaq?

SAIMIRI – Kaq.

FISNIKU – Nuk i ke shtuar e as hequr asnjë presje dëshmisë së parë! (*Saimiri pohon me kokë*) Të njëjtat fjalë thotë edhe miku yt Zeneli...

SAIMIRI – Atëherë, përse e zgjat?

FISNIKU – Sepse akoma shpresoj, të më thuash të vërtetën.

SAIMIRI – Nuk ka të vërtetë tjetër...

FISNIKU – Ka. (*Ngrihet në këmbë*) Po kaq pushtet paska mbi ty ky njeri, xhanëm, sa qorrazi të marrësh përsipër barrën e rëndë të një krimi? Kaq borxh i qenke atij njeriu, me të cilin je njohur rastësisht dhe s'mund të thuash dy fjalë të sakta për të? Natyrisht, ti s'je pa faj, por vërtetë nuk e kupton, se kështu e rëndon veten më tepër?

SAIMIRI – E ke fjalën për dënimin? Për mua pak rëndësi ka, një ditë, një vit apo më shumë. I njollosur se i njollosur...

FISNIKU – Ka njolla që hiqen me ujë, te tjera me benzinë apo diçka e tillë, por ka edhe nga ato që të mbeten për tërë jetën. E kuptoj se diçka çuditërisht e fortë të lidhka me atë njeri... Sa për ato, që më tregove, jam gati t'i rrëzoj me fakte, veçse desha, që ajo e vërtetë të dilte nga goja jote. Në qoftëse e ke të vështirë, po të ndihmoj unë, sepse e kam për detyrë, jo

thjeshtë si Saimir, por edhe ndaj kujtdo në kushtet tuaja, të cilin s' duhej ta lidhte as fija më e hollë me një fëlliqësirë si ai, e jo më t'i shërbente si mashë!

SAIMIRI – Mashë?

FISNIKU – Pse çuditësh? Për të realizuar qëllimet e tij, i duhej një mashë si ti, një i ri, i fortë... Dhe në një farë shkalle ia arriti qëllimit. Haje sapunin për djathë, të tha dhe ti e kollofite qorrazi, pa menduar, pa kontrolluar vendin, ku hidhje këmbën, madje, kaq shumë të ka trullosur me hashashin e tij, sa vazhdon ta marrësh në mbrojtje, me një vendosmëri që të habit. Mos i ke dhënë gjë fjalën? Po fjala i jepet një njeriu të mirë dhe besnik e jo atij, që të pret në besë...

SAIMIRI – Si the?

FISNIKU – Pse çuditësh? Atij që të pret në besë, thashë...*(Pauzë)* Cili nga ju e qëlloi me thikë viktimën?

SAIMIRI – Me thikë? Asnjëri...

FISNIKU – Po. Bile dy herë në shpatullën e majtë! Mos ke ndërmend që edhe këtë ta marrësh përsipër mbi shpatullat e tua?

SAIMIRI – Më jep një cigare...*(Pauzë)* Dua të të bëj një pyetje, në qoftëse më lejohet. *(Fisniku i bën një shenjë, që të pyesë)* Nga nisësh se e kemi qëlluar me thikë?

FISNIKU – Këtë e dëshmon i dëmtuari.

SAIMIRI – *(I gëzuar)* Pse, qënka gjallë?

FISNIKU – Po.

SAIMIRI – Të faleminderit, më lehtësove shpirtin!

FISNIKU – Pse, e dije të vdekur?

SAIMIRI – Ashtu dëgjuam të nesërmen, përpara se të na arrestonin dhe nuk e desha veten...

FISNIKU – Ka qënë vërtetë shumë rëndë, por e kaloi rrezikun... Ai ka dëshmuar se në fillim e ka qëlluar me grusht Zeneli, pastaj ti me diçka të hekurt, gjë që e vërteton edhe ekspertiza nga disa çarje lëkure në formë të çrregullt. Ku e gjete dorezën?

SAIMIRI – Ma kishte dhënë Zeneli dy ditë më parë!

FISNIKU – Nuk e di ti që ligji dënon ata, që mbajnë armë të ftofta pa leje?

SAIMIRI – E mbajta si lodër... Kurrë nuk më kishte shkuar ndërmend se mund ta përdorja ndonjëherë...

FISNIKU – Tani përpiqu të rikujtosh skenën me hollësi. Ja, na e përshkruaj, sikur ka ndodhur këtu. E zëmë, se klubi është atje në qoshe! *(Tregon me gisht)*

SAIMIRI – Sa po dilnim nga klubi, në fillim unë... Zeneli u ndal të paguante...

Saimiri ngrihet të improvizojë skenën. Fisniku nuk luan nga vendi, por sodit ngjarjen. Saimiri del nga i ashtëquajturi "klub". Pas tij Zeneli. Ndriçohet një pjesë e paraskenës.

ZENELI – Ama, u kënaqëm.! Ke filluar t'ia thuash mirë gotës..

SAIMIRI – Ty s'ta kaloj kurrë... Je i pathyeshëm!

ZENELI – *(Qesh me të madhe)* Ha, ha, ha! *(Sheh Esatin. Matet të ikë.)*

SAIMIRI – Ç'pate?

ZENELI – Rrodhja!

SAIMIRI – Kush është ai?

ZENELI – Një maskara. Më erdhi hakut në punë. S' dua ta shoh me sy, se do të më kërcejnë dreqërit!

SAIMIRI – Po vjen këtu...

ZENELI – Dëgjo, nëqoftëse e zgjat, do t'ia këpus. Ti mos më lër në baltë, se është i fuqishëm djalli dhe mua më merren këmbët...

ESATI – *(Afrohet)* Mirëmbërëma!

ZENELI – Mirëmbërma, Esat, hajde pije një gotë!

ESATI – T’u rritë ndera! Po kisha një muhabet. *(Saimirit)* Nuk të vjen keq, t’i them diçka Zenelit? *(Saimiri tund supet)*

ZENELI – E bisedojmë pak më tutje Esat. *(Saimirit)* Besoj, se nuk të mbetet qejfi!..

Largohen. Dëgjohej një zhurmë rrahjeje. Saimiri vrapon jashtë skene. Pas pak Saimiri dhe Zeneli futen në skenë të alarmuar dhe të rraskapitur.

ZENELI – Qeni i qenit!

SAIMIRI – Shiko, si përpëlitet!...

ZENELI – Aty të ngordhë! Po ty, mos të hyri gjë lepuri në bark?

SAIMIRI – Jo, më vjen keq... Për një fjalë goje...

ZENELI – Je qumështor akoma, megjithatë dorën plumb e kishel!

SAIMIRI – *(I shqetësuar)* I rashë me dorezë, Zenel, e kupton?

ZENELI – Qetësoju! Ja, po shkoj ta shoh, si e ka gjendjen... *(Largohet)*

Ndriçohet skena, ku qëndron Fisniku.

SAIMIRI – *(Afrohet)* Më jep një cigare. *(Fisniku i jep cigaren, Saimiri e ndez dhe e pi me të shpejtë)* S’më zinte vendi... Edhe pija sikur më kishte dalë. Po më vinte keq për atë njeri dhe njëkohësisht fillova ta ndjej se ç’gabim kisha bërë. Pastaj erdhi Zeneli...

Përsëri ndriçohet skena Zenel - Saimir.

SAIMIRI – Hë?

ZENELI – Keq, nuk lëviz fare!

SAIMIRI – Mos e kemi vrarë, Zenel!

ZENELI – U bë ç’u bë, ec të ikim...

SAIMIRI – Si të ikim, ndoshta ka nevojë për ndihmë...

ZENELI – Qenke i çmendur! Dashke, që të na kapin me presh në duar? Mbathja, ç’pret!

SAIMIRI – Unë nuk vij.

ZENELI – Mbathja, po të them! Ndoshta, nuk është edhe aq keq... Dëgjo! Askujt, asnjë fjalë! Asnjëri nuk do ta marrë vesh, po nuk fole...

SAIMIRI – Do të flasë ai...

ZENELI – Ne jemi dy. Do të themi, se të kishte ngacmuar motrën, bile unë nuk kam qëlluar fare... Kështu është më mirë... Një me një. Aq më tepër, që jam baba fëmijësh...

SAIMIRI – *(I vrarë në shpirt)* Rri pa merak, se ty nuk të ngatërroj...

ZENELI – E shoh, se të mbeti hatri, po kështu është më mirë edhe për ty. Ai të kishte ngacmuar motrën... Ti deshe vetëm të sqaroheshe. Ai të qëllloi. Ti u vetëmbrojtë, e godite. Para disa ditësh kishe gjetur rrugës një dorezë. Kështu, për vetëmbrojtje, ti përdore dorezën, po nuk deshe ta dëmtoje rëndë. Po të kapën, natyrisht! Dhe ke për të parë, se kështu nuk ndahesh keq. Le që ke qënë edhe i pirë...

SAIMIRI – Po ai mund të ketë vdekur!...

ZENELI – Vrasje pa paramendim. E lëmë kështu? Besë burrash! Hajde, mos ki frikë se s’ka për të ndodhur asgjë! S’të kam njohur kaq të ligisht, mor çun! Kështu, pra!

Ndriçohet skena ku rri Fisniku. Nga ana tjetër vjen Saimiri.

SAIMIRI – Kjo është e gjitha.

FISNIKU – Nuk deshe t’i dilje fjalës?

SAIMIRI – Po, kështu sikur lahesha me të...

FISNIKU – Përse?

SAIMIRI – Më kishte mbajtur kaq kohë me para...

FISNIKU – Për të cilat ti asnjëherë nuk pyete, si i fitonte. Asnjëherë ti nuk pe prapa tyre bixhozin, vjedhjen, matrapazllëkun. Ai të kishte verbuar dhe ti i shkoje prapa si një manar i bindur dhe i butë. Ti nuk e kuptoje, se ai të kishte futur në kllapë. Dhe kushedi në ç’shtigje të tjera do të të shpinte! Zaten, jo më kot kishte shpenzuar aq shumë...

SAIMIRI – Atë natë vendosa të pranoja atë, që s’më takonte, sepse desha të ndëshkoja veten, për atë që ndodhi, edhe për rrugën që kisha nisur... Dhe dije mirë, pavarësisht se e kuptoja, që po bëhesha fajtor për atë ngjarje, këto që dëgjove tani s’kishe për t’i mësuar kurrë, po të mos ishte ajo thikë e ngulur pabesisht, atëherë kur Zeneli shkoi “të shihte, si e kishte gjendjen” ai rrezikziu! Një gjë desha të sqaroj, natyrisht nëqoftëse më lejohet. Vetëm për çeshtje pune deshi ta vriste?

FISNIKU – Më tepër për atë shumë të madhe parash, që Zeneli ia kishte dhënë borxh Esatit, të cilat ai i kishte humbur në bixhoz...

SAIMIRI – *(Vë duart në kokë)* Hajde qorr, qorr!

Përsëri në kantier. Pali është i tronditur nga tregimi i Fisnikut.

PALI – Asnjëherë nuk e kam pyetur për shkakun e dënimit. Po ky është kulmi, të vrasësh një njeri për ca para!

FISNIKU – Po, Pal, kjo ishte e gjitha! Dhe ai, për hir të fjalës së dhënë, donte të mirrte përsipër krimin, që nuk e kishte kryer... *(Saimiri zbret)*

PALI – Pra, po largohesh?

SAIMIRI – Dikush duhej të shkonte...

PALI – Por jo ti. Sidomos tani.

SAIMIRI – Asnjëherë nuk jam larguar nga shtëpia më me dëshirë, se sa tani. Mirë u pafshim!

Sapo largohet e thërret Jera, që ka hyrë.

JERA – Saimir! Saimir!

SAIMIRI – *(Ndalet me mëdyshje)* Ti?

JERA – Po. Si je Saimir?

SAIMIRI – Unë mirë, po ju?

JERA – Po ti prit pak, sikur je mbi thumba...

SAIMIRI – Nxitoj..

JERA – Dua të flas.

SAIMIRI – Nuk kam kohë. Më fal!

JERA – Po ti, për ku kështu? Nuk të paska marrë malli?

SAIMIRI – Ti s’duhet të vish më këtu, Jera!

JERA – Je zemëruar me mua, pse s’kam ardhur këto ditë? Do të sqarohemi...

SAIMIRI – Të thashë, nuk kam kohë...

JERA – S’ka gjë, po të shoqëroj.

SAIMIRI – Rrugën do ta bëj me vrap...

JERA – Edhe unë...

SAIMIRI – Ty s’duhet të të shohin me mua, apo jo! Kjo është më se e drejtë. Ti ndryshon nga unë.

JERA – Të lutem, Saimir, mos fol kështu. Po të ishte si thua ti, nuk do të vija këtu.

SAIMIRI – Tepër vonë. Ika!

JERA – Po mirë atëhere, meqë s’paske kohë tani, shihemi pas dreke.

SAIMIRI – Jo, ne s’do të shihemi më kurrë! (*Ikën pothuajse me vrap*).

PALI – (*Jerës*) Jera!

JERA – (*E dërrmuar*) Si je, Pal?

PALI – U ndatë?

JERA – Po, për të mos u takuar më. Ashtu më tha. Është zemëruar keq.

PALI – Ka të drejtë.

JERA – E di, gjithë këto ditë që i shmangem...

PALI – Në qoftëse më lejon, a mund ta di shkaku?

JERA – Një turbullirë e përkohshme...

PALI – E përkohshme?

JERA – Po..

PALI – Pse, kështu?

JERA – E paprituara gjithmonë sjell çaste hutimi... Kështu ndodhi edhe me mua. Nuk mund të më falet një gabim të tillë?

PALI – Njeriu është i fortë dhe duhet të mbledhë veten, se, në fund të fundit, ç’borxh të ka tjetri, që të mbajë mbi shpatulla fyerjen qoftë edhe në çaste hutimi?

JERA – Si the, Pal, fyerjen?

PALI – Për të s’mund të ketë fyerje më të rëndë, se t’i lëndosh një plagë të tharë krejtësisht...

JERA – Nuk po të kuptoj, Pal. Si është e mundur? Saimiri vetëm me mend mund ta ketë marrë... Po unë...

PALI – Pavarësisht se si do të vijë punët, ti ke bërë një gabim të madh dhe këtë duhet ta ndjesh.

JERA – Po të qe ndryshe, nuk do të vija. Dhe këtë e kam menduar mirë gjithë këto ditë. Ke dëgjuar ndonjëherë të thonë “Më ra si rrufe në qiell të pastër”? Edhe unë kisha dëgjuar, por të them të drejtën, kurrë nuk kisha menduar të futem në brendinë e këtij krahasimi disi ta çuditshëm. Por për mua, ajo që mësova befas, ishte me të vërtetë një rrufe e tillë, që më këputi në çast, më mpiu trupin dhe mendjen, e quajta veten të zhgënjyer, të humbur... Po unë prandaj të thashë, që kjo ishte e përkohëshme, sepse pastaj fillova të shoh dritë, aty ku më parë s’kishte veçse errësi. Saimiri nuk ishte mashtrues dhe i pasinqertë. Ai ishte i mire, ashtu siç e kisha njohur dhe ndjenja ime nuk mund të quhej e zhgënjyer..

PALI – Kjo është më se e vërtetë dhe s’duhej ta kishe menduar kurrë!

JERA – Po ti, a nuk do të kishe menduar si unë, po të kishe dëgjuar papritmas atë, që duhej ta dije me kohë nga ai, të cilit i kishe besuar gjithçka?

PALI – Jam i bindur, që do ta thoshte vetë një ditë.

JERA – Pal, ajo që mësova ishte vërtetë e rëndë, por njeriu, kur do me gjithë zemër, e gjen forcën, natyrisht, për gjëra, që duhen kapërcyer dhe kur nuk mungon sinqeriteti. Kjo e fundit për mua ishte shumë e rëndë... Pikërisht kjo edhe më theu një çast, por më vonë m’u kujtua nata e fundit. Atë natë i thashë, se kisha ndërmend të bisedoja me babain, por ai kundërshtoi. Një herë tjetër, më tha, një natë tjetër, sepse kam për të të treguar shumë gjëra... A nuk e ka patur fjalën pikërisht aty? Kjo më ngrohu shumë, më vonë, më përtëriu dhe më dha forcë. E ndjeva, se kisha gabuar rëndë, që kisha menduar keq dhe isha shmangur këto ditë. Prandaj erdha dhe nuk do t’ia zija me gojë. Ai vetë le të ma thoshte..

PALI – Si the, nuk do t’ia zije me gojë?

JERA – Po, ashtu thashë...

PALI – E çuditshme!

JERA – Ç’ka për t’u çuditur?

PALI – Ka, sepse ti ia ke “zënë njëherë me gojë” dhe pikërisht kjo e ka lënduar rëndë...

JERA – Jo, Pal, nuk është e vërtetë. Unë nuk i kam thënë asgjë. Unë vetëm kam luftuar këto ditë në heshtje me veten time. Saimiri mund t’i ketë marrë me mend krismat e kësaj lufte, vetëm me mend, po ato nuk i ka dëgjuar nga unë. Kjo është e vërteta!

PALI – Më fal, po si mund të ketë njëkohësisht dy të vërteta për një problem? Pastaj mund edhe të mos ia thuash vetë, po përmes një njeriu tjetër, njëlloj është ajo punë...

JERA – Jo, nuk kam nevojë për avokat mbrojtës... Askush s’ka të drejtë të luajë këtë rol. Punët e mia i zgjidh vetë...

PALI – Megjithatë dikush e ka luajtur këtë rol, duke folur në emrin tend.

JERA – Si është e mundur? Me ç’të drejtë?

PALI – Më mirë këtë pyetje bëja nënës tënde!

JERA – (*E befasuar*) Jo, jo, s’ka mundësi!

PALI – Fatkeqësisht, po...

JERA – Atëherë, dashje pa dashje, qenka shembur gjithçka! Saimiri ka të drejtë! Më fal, Pal! Më duhet të shkoj. Ditën e mirë! (*Del*)

Dritat

Tabloja e Pestë

Shtëpia e Jerës. Pasdreke. Avniu lexon. Jera del nga dhoma përballë.

AVNIU – Pushove?

JERA – Po.

AVNIU – Ç'paske kështu? Të qënkan enjtur sytë!

JERA – Më dhemb koka...

AVNIU – Nuk më thua të vërtetën. Ti ke qarë. Eja, ulu këtu pranë meje! S'bën të lëndosh veten kështu, Jera. Njeriu ndesh në jetë në gjithfarë pengesash e vështirësish. Kush ka zemër të fortë e mendje të kthjellët, i kapërcen. Ty, vërtetë, të ndodhi, që u rrëzove qysh në hapin e parë dhe sigurisht, shpirti të dhemb, po ç'të bësh... Gjëra që ngjasin! E rëndësishme është të kuptosh, se në këtë mes ti je krejtësisht e pastër dhe aspak fajtores...

JERA – Për këtë temë, baba, nuk ia vlen të flasim më...

AVNIU – Si të duash, moj bijë, por nuk mund të të shoh kështu të mërzitur.

JERA – *(Thekson)* Do të më kalojë...

AVNIU – Ti je kryesorja, ne të tjerët vijmë pas teje. Dhe s'do mend, që e kemi më të lehtë.

JERA – Po, po ju e keni më të lehtë...

AVNIU – E megjithatë diçka më bren. Qëndrimi yt i ftohtë këto ditët e fundit më bën të mendoj, se mos diku e kam shkelur. Thuamë të vërtetën, se dua të jem i qetë, mos të kam lënduar me ndonjë veprim të padrejtë?

JERA – Jo.

AVNIU – E thua me gjithë mend?

JERA – Unë nuk jam prind, të gjykoj si prind. Nuk e di, ç'do të bëja, po të isha në vendin tend, por për një gjë jam e sigurtë, kurrë nuk do të veproja, ashtu siç ka vepruar mamaja...

AVNIU – Mamaja?*(bie zilja)*

FISNIKU – *(Që hyn)* Mos iu prisha ndonjë bisedë?

AVNIU – Jo, jo. Shahun nuk e paske marrë?

FISNIKU – Më mirë luajmë në natyrë, në qoftëse ke kohë e nuk mërzitet Jera. Pijmë edhe një kafe jashtë, se Dita nuk qenka në shtëpi, kurse Jera nuk do të mirrte ndonjë notë të mirë në pjekjen e kafesë... *(Jerës)* Si thua, na jep leje?

JERA – *(Si me shaka)* Ti e paske vendosur, kot më pyet!

FISNIKU – Ngrehu, Avni, ke vajzë të mençur! *(Dalin)*

JERA – *(Sillet nëpër dhomë pa ditur ç'të bëjë. Bie zilja e telefonit. Ajo ngurron një cast, pastaj merr dorezën dhe flet)* Alo, alo! Kush je ti? Ti qenke, Lira! Po pse s'mu përgjigje menjëherë, apo kërkon të talleh? Po, po, ke të drejtë, se e ke gjetur kohën. Unë? E ç'plane do të kem! Ja, të rri brenda në dhomën time, që të shfrej... Do të bëj sikur do të ha, sikur do të flë. Nesër në punë. Nga puna në shtëpi dhe cikli do vazhdojë... Deri kur? Nuk e di. Si the? Të dalim? Jo jo, nuk kam dëshirë, po të duash, eja ti këtu. Vetëm jam...

Ul dorezën. Hyn Dita dhe Xhidja me çanta të mbushura në dorë.

XHIDJA – *(E përqafton)* Si je, të keqen halla, mirë? Ashtu duhet, t'u bëfsha, ta mbledhësh veten, se nuk u bë qameti!...

DITA – Avniu nuk qenka?

JERA – *(ftohtë)* Doli...

DITA – Ku shkoi? Se, kur i thashë të bënim bashkë pazarin, më tha, se kishte punë! Mezi erdha. Shyqyr, që takova rrugës Xhiden! Nuk të tha, se ku do të shkonte?

JERA – Me Fisnikun.

DITA – (*Xhides*) Prit, ku shkon! Ende nuk more frymë mirë...

XHIDJA – S’kam kohë. Kemi lënë me Vehbiun një vizitë...U largova për dhjetë minuta deri në kinkaleri, se më ishte mbaruar i kuqi i buzëve dhe më fluturoi një gjysëm ore. Vehbiun e lashë duke u rrojtur...Do të jetë xhindosur!

DITA – Vetëm një kafe. I thuaj, që më ndihmove... (*Jerës*) Na i piq dy kafe! (*Jera del pa fjalë*)

XHIDJA – Tërë hundë e buzë vajza!

DITA – Është bërë si e huaj në shtëpi...Më dhimbset shumë!

XHIDJA – Duhet patur kujdes, se në raste të tilla edhe...(*Bën me dorë për çmendje*)

DITA – Larg qoftë!

XHIDJA – A janë takuar më me njeri tjetrin?

DITA – Më duket se jo...Pasdrekeve nuk del fare...

XHIDJA – Nuk është e thënë të shihen pasdreke... Një herë për një here, ju mjafton edhe paradrekja...Ku ta dish, ndoshta del dhe e pret në mëngjes...E përcjell për në punë, i rregullojnë pipat fët e fët, sa për të na hedhur hi syve dhe...na rroftë!

DITA – Kam marrë vesh, se ai është larguar nga puna...

XHIDJA – E kanë hequr?

DITA – Jo, ka shkuar në hekurudhë...

XHIDJA – Paska ndodhur si me porosi! Nuk thonë kot, larg sysh, larg zemrës...Do kishit bërë mirë, që të kishit prishur edhe telefonin përkohësisht, se ky djall është si puna e erës, që ta ndez zjarrin më shumë...

DITA – Nuk ma merr mendja... Jerën pikërisht e ka thyer mosinqeriteti i tij e këtu patëm fat... Avniu kishte të drejtë! Po t’ia dinte kleçkën më parë, apo t’ia kishte thënë ai vetë, zor se do të shqitej prej tij...Ia njoh kokën!

XHIDJA – Aq më mire, atëherë! Është tamam koha të sulmojmë!

DITA – Kë të sulmojmë?

XHIDJA – Jerën!

DITA – Je në vete?

XHIDJA – Po. T’i afrojmë variante, natyrisht, sa më të mira... Ndodh nganjëherë, që në inat e sipër ti vendos për diçka, që nuk do ta vendosje më parë...

DITA – Erdhi! (*Jera hyn me kafetë. Xhidja surbon kafenë*)

XHIDJA – Ma paske bërë të idhët, moj mbesë...Unë e pi të ëmbël!...Ke harruar?

JERA – Më fal...

XHIDJA – S’ka gjë, ja, më shto një lugë sheqer në filxhan dhe bukuri! (*Jera del*) Si thua, t’ia zë në gojë dentistin?

DITA – Nuk është koha...

XHIDJA – Ç’ke ti, e dredh unë ëmbël ë ëmbël...

DITA – Të mos ngutemi...(*Hyn Jera. I hedh sheqer*)

XHIDJA – Mjaft, mjaft!

Dëgjohet zilja e telefonit. Jera është në këmbë dhe bëhet gati të shkojë tek telefoni, por Dita thuhetse vrapon me të shpejtë dhe e ngre dorezën.

DITA – Alo! Po, familja Abazi, jemi...Po ju, kush jeni? (*Jera ngre kokën*) Aha, ti quenke, Genci! Mirë jeni? Prindërit, mirë janë?

Jera këtu është! Do të vish vetë? Epo, aq më mirë! Jo, jo, nuk ka ndërmend të dalë! (*Ul dorezën*) (*Jerës*) Ishte Genci!

JERA – E mora vesh, mama...

DITA – Të kishte gjetur metodën e anglishtes.

XHIDJA – (*Jerës*) Kush është Genci?

JERA – Një shok.

DITA – Djalë flori!

XHIDJA – Nuk e njoh unë?

JERA – Po ti s'je Zyra e Gjendjes Civile, moj hallë!

DITA – Ka një shtëpi të madhe në fund të rrugicës...

XHIDJA – Mos e ka të ëmën drejtoreshë çerdhjeje? (*Dita tund kokën në shenjë pohimi*) E njoh... Janë familje e mirë shumë! Sidomos, e ëma...

DITA – Janë njohur në kursin e anglishtes...Jera ka nja dy herë, që nuk ka shkuar, kështu që ai...

XHIDJA – E ç'të keqe ka! Të rinj janë, edhe do të njihen me njeri tjetrin!..Le ta mësojnë anglishten bashkë, se tek e fundit, kulturë është...Kur tha, se do të vijë, tani?

DITA – Më vonë...

XHIDJA – Po e pres...Kam shumë qejf ta njoh djalën e drejtoreshës...

JERA – Vizitën po e lë, hallë?

XHIDJA – Ua, harrova! Do të jetë tërbuar Vehbiu! I bëni të fala nga ana ime djalit të drejtoreshës! (*Jerës*) Unë mendoj, që anglishtja është më e bukur se frëngjishtja, moj mbesë...Mos e lër përgjysëm!...Ika! (*Del me të shpejtë*)

DITA – Do ndonjë kumbull?Ishin shumë të mira...

JERA – Nuk dua tani...

DITA – Si të duash, aty i ke! Edhe ky Avniu, si e bën shtëpinë! Edhe dreqi thyen këmbët në këtë rromujë!... Të vijë e të më gjejë Genci kështu, kushedi ç'do të mendojë... (*Fillon të rregullojë dhomën*)

JERA – Anjëherë nuk je shqetësuar për ardhjen e Gencit si sonte!...

DITA – Nuk e di pse, por më ka hyrë në zemër ky djalë dhe sa i sjellshëm është...

JERA – Më vjen keq për hallën, që humbi rastin ta shihte! Me siguri, edhe asaj do t'i kishte pëlqyer...

DITA – (*Nuk kupton*) Ne s'jemi kundër, që ti të kesh një shok si ai! Se ç'ka një veti, që menjëherë të bën për vete...

JERA – (*Vazhdon lojën*) Eshtë e vërtetë, edhe mua më pëlqen të rri me të, sidomos kohët e fundit! Sikur më plotëson një boshllëk...

DITA – Eh, sa do të gëzohesha...

ERA – Për çfarë, mama?

DITA – Jo, jo hiç. Këto janë punët tuaja. Nuk kam ndërmend të përzihem...

JERA – S'do mend, mama, përderisa asnjëherë nuk je përzier!..

DITA – Tani po flet me thumba. Po a mund të quhet përzierje shqetësimi i nënës dhe babait, që mundohen t'i hapin sytë fëmijës?

JERA – Ose t'ia mbyllë...

DITA – Ç' do të thuash me këtë?

JERA – Thashë, që tjetrit mund t'ia mbyllësh sytë të shohë atë që duhet të shohë, veshët që të mos dëgjojë atë, që i pëlqen të dëgjojë dhe gojën që të mos flasë atë që do të flasë...

DITA – Ç'është kjo lojë fjalësh? Unë nuk e di, që dikush të ketë vepruar kështu me ty, moj bijë. Që për diçka më mban mëri, sidomos këto ditët e fundit, e kam kuptuar. Shkakun s'jam në gjëndje ta di. Nuk kisha ndërmend të të pyesja, por ti bërë mirë, që e hape këtë bisedë.

JERA – Jo, por po ma përmend Gencin kaq herë...

DITA – E ç'të keqe ka këtu?

JERA – Gencin e kam shok të mirë, vërtetë, por unë nuk jam budallaqe, që të mos e kuptoj, se ti bashkë me hallën, me siguri, tani për tani e keni vënë në krye të listës së kandidatave! (*Bie zilja. Dita shkon te telefoni*)

DITA – Alo, Dita jam! Po, po, këtu është, e do në telefon? Si të duash...Mirupafshim, zemër! Ishte Lira. Tha, ta marrësh më vonë.

JERA – Po pse, moj mama, s' ma hoqe këtë barrë që tani? Ti mund të flasësh, kur të duash në emrin tim!

DITA – Po më rëndon shumë, moj bijë...

JERA – Aspak, madje rri e qetë, se edhe në qofsha vetëm, nuk do ta prek me dorë telefonin pa lejen tënde...

DITA – Moj, çfarë thua kështu, je apo s'je në vete? Kush ta paska ndaluar telefonin?

JERA – Gadishmëria jote për të vepruar, sa herë që bie zilja; frika që ke, se mos dëgjoj përsëri zërin e atij, që do të më ndërronte mendjen. Por gabohesh, mama. Nuk ke për ta dëgjuar më zërin e atij! Rri pa merak, se çdo gjë është shembur! Falë kazmës sime dhe buldozerit tënd!

DITA – (*E përmban veten*) Nuk kisha menduar ndonjëherë, se do të vinte një ditë, që të rrija e të dëgjoja fyerjet e pjellës time... Vazhdo bijë, jepi! Coptoja më tepër zemrën e nënës, se ndofta lirohesh!..

JERA – Vetë më kërkove shkakun. E kjo nuk është fyerje, por një e vërtetë, që duhet thënë.

DITA – Atëherë mos u hidh degë më degë, por bjeri troç!

JERA – Përse ke folur në emrin tim, mama?

DITA – Kujt i kam folur dhe çfarë i paskam thënë?

JERA – Atij edhe ato, që nuk duhej t'ia kishe thënë kurrë.

DITA – Nuk kam shpifur.

JERA – As ke patur të drejtë.

DITA – Këtë të drejtë ma jep gjaku im, që ka ushqyer zemrën tënde.

JERA – Por jo të tijën.

DITA – Zemra e tij nuk më hyn në punë.

JERA – Mua po.

DITA – Atëherë mos më dërdëllis më gjatë, por shko te ai!

JERA – Është tepër vonë, nuk kam më fytyrë, t'i dal përpara, edhe po të dua unë...

DITA – Paska edhe sedër, zotëria!

JERA – Po vazhdon ta fyesh...

DITA – Atë natë, që ti i mësove kleçkën, mendoje ndryshe...

JERA – Ishte një hutim i përkohshëm, megjithatë nuk thashë asgjë.

DITA – E thanë duart, që vure në kokë dhe kjo s'ka nevojë për fjalë...

JERA – E humba një çast, se m'u duk e rëndë...

DITA – Ndërsa tani të qenka lehtësuar!

JERA – Ndjenja ime për të ishte më e fortë. Gabimi i së shkuarës nuk ka lënë asnjë gjurmë në karakterin e tij...

DITA – Përveç syve, ke humbur edhe mendjen. I verbri me mendje të kthjellët i dallon gjurmët, ndërsa ti jo. Përderisa nuk të bën përshtypje mosinqeriteti apo, po ta them troç, mashtrimi...

JERA – Nuk është kështu.

DITA – Nuk ka emër tjetër. Dhe të mos ia dëgjoj më emrin e zërin!

JERA – Nuk do t'ia dëgjosh. Desha vetëm, t'i vija gjërat në vend, siç duhet, pavarësisht se nuk ia arrita. (*Fillon të vishet për të dalë*)

DITA – Ku po shkon?

JERA – Po dal. Nuk lejohet?

DITA – Tani duhet të vijë Genci...

JERA – Rrini bashkë. Dhe vendosni, si t'u vijë për mbarë. Tani s'ka më rëndësi asgjë për mua...*(Del)*

DITA – *(Me vete)* Eh, si erdhën punët!... Ku shkuan gjithë ato ëndrra të bukura e të bardha, që i përkunda për vite të tëra, që kur ishte kërthi e deri tani, që mund të bëhet nënë?
(Avniu hyn) E bëre shëtitjen e darkës?

AVNIU – Dola me Fisnikun.

DITA – Ç'më duhet Fisniku? Kur unë të thashë, ec e më ndihmo të bëjme pazarin, me nxorre një mijë e një kleçka...

AVNIU – Bëra mirë, që dola...

DITA – Po, po, ke nevojë!

AVNIU – Qenke e acaruar. Ku është Jera?

DITA – Nuk e ndeshe rrugës?

AVNIU – Jo, ku shkoi?

DITA – Nuk e di.

AVNIU – Mirë, që s'qenka këtu, se mund të flasim më lirshëm. Mbasi duhet të shohim me gjak të ftohtë çështjen e saj...

DITA – S'kemi, ç'të shohim!

AVNIU – Mos u ngut. Prandaj kishte ardhur Fisniku.

DITA – Ç'hyn Fisniku këtu?

AVNIU – Punojnë bashkë, më foli gjatë dhe vetëm fjalë të mira...

DITA – Fisniku të shikojë punën e tij, se nuk i di të gjitha...

AVNIU – Më mirë se kushdo tjetër.

DITA – Nuk më intereson. Mbi kurrizin e tjetrit, gjithkujt i duket barra më e lehtë...

AVNIU – Ne që e kemi më të rëndë, të shohim mos e lehtësojmë..

DITA – Pse ta ngacmojmë, kur ajo vetë tha, se çdo gjë ka mbaruar një herë e përgjithmonë...

AVNIU – Kur të tha?

DITA – S'ka dhjetë minuta. Ty të kam dëgjuar mjaft. Asnjë mos thuaj. Kjo temë nuk do të hapet më në këtë shtëpi!...

Dritat

Tabloja e Gjashtë

Rruga pranë kafenesë. Pali e Saimiri ecin ngadalë.

PALI – Po më dëgjove mua, ti duhet ta lësh mënjanë sedrën. Shko dhe takoje!

SAIMIRI – E kam të vështirë, Pal...

PALI – Vetëm për një çast, pastaj çdo gjë do të kthjellohet..

SAIMIRI – Nuk e di...

PALI – E vë në dyshim? Ç’thua, more, je në vete, apo jo? Kërkon ta thellosh hendekun edhe më tepër? Mos pret që të të bjerë në gjunjë?

SAIMIRI – Jo, as që më shkon ndërmend. Tani e kuptoj Jerën më së miri dhe i jap të drejtë. Ajo është krejt e pafajshme. Atë ditë që erdhi në kantier, nuk e dija shkakun. Ndërsa unë...

PALI – Domosdo, edhe ti ke racionin tënd!

SAIMIRI – E di, duhet t’ia kisha treguar të gjitha që në fillim. Ajo, pastaj, le të vendoste, pa qenë nevoja ta merrte vesh nga prindërit. Por ti më kupton Pal... Të betohem! Nuk është se doja ta fshihja atë njollë. As nuk prisja që ajo të zhytej më thellë në dashuri, që pastaj të mos kishte rrugë nga të dilte. Jo. Do të isha i poshtër! Ajo, që kisha bërë dikur, më dukej, sikur nuk më përkiste mua, më kupton, sikur ishte diçka e huaj, të betohem! Ia kisha nënvleftësuar peshën, kur shihja nga të gjithë, sa sinqerisht e me ngrohtësi më futët në shoqërinë tuaj si të barabartë. Askush nuk ma ka zënë në gojë, askush nuk më ka parë me atë sy... Të paktën, kështu me dukej mua dhe gradualisht fillova ta harroj, ta fshij nga kujtesa. Këtu ka qënë gabimi im. Por ti më beson, Jerës do ja thoja një ditë. Desha ta hap që atë natë, por se si më erdhi. Pastaj erdhi Esat Luka dhe e lashë për një natë tjetër. Mirëpo ngjarjet rrodhën aq shpejt, siç nuk e kisha menduar kurrë..

PALI – (*E ndërpret*) S’duhej të mjaftoheshe vetëm me telefonin. Jerën duhej ta kishe takuar patjetër.

SAIMIRI – E prita tri ditë rrjesht, por ajo nuk doli në punë...

PALI – Të gjeje një mënyrë tjetër.

SAIMIRI – Kam provuar. I shkova në shtëpi...

PALI – Kur?

SAIMIRI – Një pasdreke, para se të vinte në kantier.

PALI – Fole me të?

SAIMIRI – Jo, prita plot dy orë përballë shtëpisë së saj, me shpresë se mos dilte në dritare apo ballkon. Disa herë e pashë të lëvizë perdja e aneksit. Vendosa t’i shkoj në shtëpi. I rashë ziles gjatë, por dera nuk u hap. E kuptova, që s’donin të ma hapnin kurrë dhe ika. Unë, vërtetë, kam bërë faj, por jetën kam vendosur ta ndërtoj ndryshe, të pastër, pa menduar, se do të arrij diçka të pa merituar ndonjëherë, apo thjeshtë për mëshirë e dhembshuri. Kjo do të më cënonte personalitetin. Kam edhe unë të drejtë të flas për personalitet, apo jo?

PALI – Patjetër. Megjithatë, Jera mund të mos ketë qënë në shtëpi...

SAIMIRI – Mundet, po përse nuk ma hapën derën, kur brenda kishte njerëz? Tek e fundit, përse duhet, që Jera të bëjë diçka në kundërshtim me dëshirën e prindërve? Edhe ato kanë të drejtën e tyre... Ata nuk më njohin. Për ta unë jam, ai që kam qënë. Po të isha në vendin e tyre, ndoshta edhe unë kështu do të veproja...

PALI – E rëndësishme është të flasësh me Jerën. Mbase gjatë këtyre kohëve ka ndryshuar diçka në favorin tënd. Ku ta dish! E mira e të mirave është, që kjo të bëhet normalisht, hë për hë edhe pa ndonjë miratim të plotë nga ana e tyre. Të paktën, të ketë një

thyerje sado të vogël në fillim. Pastaj, ke për të parë, çdo gjë do të rregullohet, se fëmija është gjithçka për prindin... Si thua, do ta takosh?

SAIMIRI – E desha shumë, o Pal dhe s'e kam aspak të lehtë të tërhiqem, pa e ditur përfundimisht mendimin e saj..

PALI – Mendimin e saj ta thashë. Pse, kot erdhi të të takonte në kantier?

SAIMIRI – Para pesëmbëdhjetë ditësh... Në raste të tilla, nuk janë pak pesëmbëdhjetë ditë...

PALI – Lëri filozofitë dhe që nesër ta takosh, more vesh? (*Saimiri vë buzën në gaz*) Kushedi, sa do të na shajë Fisniku! E kemi shkelur një çerek ore... (*Futen në klub*) (*Kamerierit*) E ke parë Fisnikun?

KAMERIERI – Po ju pret tek ajo tavolina e cepit. (*Tregon me shenjë diku jashtë skenës. Ata të dy shkojnë atje.*)

Në krye të rrugës duken Jera me Gencin.

GENCI – Sot na thanë të bëhemi gati. Për një javë do të shkojmë në shtëpinë e re. Me babain nuk flitet. Është mësuar me oborrin, po unë e di, hallin më të madh e ka tek lulet. I ka pikë të dobët. Ka rastisur të bëjë edhe tridhjetë kilometra rrugë a më shumë, po të merrte vesh, se filani kishte një lloj të ri tulipani o trëndafili. Ty të pëlqejnë lulet, Jera ?

JERA – Po.

GENCI – Ama, ç'pyetje bëj edhe unë! Ku ka njeri, që s'i pëlqen e bukura? (*Matet të hyjë në klub*)

JERA – Ku shkon, Genci?

GENCI – Të hamë një akullore... Është vapë...

JERA – Jo , jo, u bëra vonë...

GENCI – Ç'ke ti! Të përcjell unë deri në shtëpi... Prindërit e dinë, që je me mua...

JERA – Nuk është puna aty, po nuk kam kohë...

GENCI – Edhe Albert Ajnshtajni, po të ishte, do të ma kishte falur një gjysëm ore, po t'i lutesha kaq shumë për një akullore!

JERA – Edhe sikur Albert Ajnshtajni të vuante nga bajamet?

GENCI – Edhe sikur të vuante nga bajamet!..

JERA – E po, mirë, s'po ta prish!... (*Ecën ngadalë*)

GENCI – Ja, ulemi aty...

Jera mbetet për një çast në mëdyshje. Është tavolina, ku është ulur vazhdimisht me Saimirin.

JERA – Ku të ulemi?

GENCI – Pse, nuk të pëlqen këtu?

JERA – Jo, jo, më pëlqen shumë! (*Ulen*)

GENCI – (*Vë një pako mbi tavolinë*) E gjen, ç'ka brenda?

JERA – Ku ta di unë!

GENCI – Provoje njëherë!

JERA – Nga mënyra se si e shtrëngon nën sqetull, mendoj, se do të jetë diçka e çmuar. Mos ke zbuluar ndonjë thesar?

GENCI – Mirë e ke, fare mirë mund të quhet thesar çdo gjë, që lidhet me kulturën... Hape, hape!

JERA – (*E hap. Janë dy kaseta magnetofoni.*) Po këta?

GENCI – Kursi i plotë i anglishtes bazë. Merri!

ERA – Unë?

GENCI – Pse habitesh? Pastaj, mos harro, bashkë do t'i shfrytëzojmë... Po të duash tek unë, ose tek ti...

JERA – Të faleminderit, Genci!

GENCI – E ç'ka këtu për të më falenderuar? Edhe ti, po të të binte rasti, do të bëje kaq për mua, apo jo! I kam pasion të madh gjuhët e huaja, Jera...Nuk mërzhitem, po të rri tërë ditën me fjalor përpara. Ngulem e s' di të çohem, aq sa ngandonjëherë babai më shan...Kurse dje shkova për të parë një tip të ri biblioteke. E bukur ishte, vërtetë, por pak e vogël...Nuk do të m'i nxinte, ose më saktë, nuk do të mund t'i ekspozoja të gjithë librat. E kam shumë zët të humbas kohë, për të gjetur një libër, që më duhet. Mos po të mërzhit?

JERA – Jo, jo.

GENCI – Ta thashë këtë, që të mos trembesh, se jo gjithmonë jam kaq fjalaman...

KAMERIERI – (*Gencit ftohtë*) Urdhëroni!

GENCI – Dy akullore.

KAMERIERI – (*Jerës*) Paskeni ndrruar shije? Edhe akulloret të mira i kemi, por pastat tona nuk i gjen në asnjë lokal tjetër... Megjithatë, si të dëshironi... (*Largohet*)

GENCI – Qenka një kamerier me kujtesë shumë të fortë! Megjithatë, s'ma ha mendja të dijet shijet e të gjithë klientëve...Padyshim, rrethi duhet të jetë i ngushtë, apo jo?

JERA – Kam ardhur shpesh këtu, Genci dhe kam kërkuar pasta gjithmonë...

GENCI – Nuk e kisha me të keq...Bëra shaka! (*Vjen kamerieri, që u sjell akulloret*) Të faleminderit! (*Hanë ngadalë*) Mbrëmë kishim për darkë motrën. Ka një djalë të vogël shumë të lezetshëm. Sapo ka filluar të ecë...Na shkrin së qeshuri, kur sillet nepër dhomë. Unë i dua shumë fëmijët, Jera..

Jera humbet në kujtime. Dritat sfumohen ngadalë. Pastaj në mikrofon dëgjohet dialogu Jera - Saimir.

JERA – Saimir!

SAIMIRI – Urdhëro, Jera!

JERA – Shiko, sa i lezetshëm ai vogëlushi tek stoli!

SAIMIRI – Po hedh hapat e parë...A ka gjë më të bukur, se kjo? Sikur përpiqet të këpusë diçka, që e mban të lidhur...Shih, si turret me këmbët e tij të njoma, pa pyetur për asgjë! I hedh pastaj sytë majtas e djathtas për të marrë miratimin e atyre, që janë përreth dhe turret përsëri si triumfator...

JERA – Shiko, shiko ç'gjuhë poetike na përdorke zotërote, kur qenka fjala për fëmijët!

SAIMIRI – Sepse i dua shumë, Jera! Është krijesa më e pafajshme, më e pastër, më e sinqertë...

JERA – Mua s'më dashke, përderisa asnjëherë nuk ke folur për mua me këtë gjuhë...

SAIMIRI - Të dua shumë, sa nuk e merr me mend, Jera!

Dalëngadalë dritat bëhen të plota. Jera ende jeton me përfytyrimin.

GENCI – Jera! Jera!

JERA – (*Përmendet*) Urdhëro, Genci!

GENCI – Më duket, se nuk po më dëgjon fare...

JERA – Si the?

GENCI – Thashë, që ke humbur diku...

JERA – Jo, jo, po të dëgjoj...

GENCI – Sa e çuditshme është kjo jetë! Dhe kur mendon, se para shumë vitesh edhe ne kemi qenë si ata, edhe ne kemi çuçuritur si zogj, jemi sjellë nepër dhomë disi fitimtarë, pavarësisht se edhe jemi rrëzuar ndonjëherë. Ne djemtë që të vegjël jemi më harrakatë se ju vajzat.

JERA – Jo, Genci, edhe ne vajzat rrëzohemi...Ja, edhe unë jam rrëzuar keqas njëherë!
(Pauzë) Ngrihemi, Genc, u bë vonë!

GENCI – Kaq shpejt?

JERA – Sonte do të qeras unë.

GENCI – Jo, të ftova unë.

JERA – S'ka gjë. Një here tjetër ti...

*Nga brenda lokalit del Saimiri. Jera ngrihet instiktivisht dhe bën dy tre hapa drejt tij.
Edhe Saimiri afrohet. Dritat sfumohen.*

Dritat

Gjysma e dytë e epilogut

Shtëpia e Saimirit.

Banketi ka kohë që ka filluar. Këndojnë, qeshin. Dëgjohet përsëri e qara e një fëmije... Jera matet të shkojë andej, nga dëgjohet e qara. Njëkohësisht me Jerën ngrihet edhe Vjollca...

VJOLLCA – Prit, Jera, merru me miqtë!

JERA – Po qan, Vjollca...

VJOLLCA – Shkoj unë dhe e përkund, ja marrtë halla të keqen! *(Ikën me vrap në dhomë)*

Nga tavolina ngrihen Saimiri dhe bashkohet me Jerën. Bëjnë disa hapa ngadalë drejt paraskenës. Lokalizim dritash.

SAIMIRI – Pushoi djali!

JERA – Ia mori dorën Vjollca! Ajo po fluturon nga gëzimi...Po edhe ai mistrec sikur po mësohet keq me të përkundur...Ju bëftë nëna! *(Pauzë)*

SAIMIRI – Jera! Shiko, sa njerëz kanë ardhur!

JERA – Po Saimir, shumë!

SAIMIRI – Dhe kanë ardhur për ne, për gëzimin tonë...

JERA – Po.

SAIMIRI – Pali s’ka pirë ndonjëhere kaq shumë në jetën e tij. Aq më tepër Fisniku. Dëgjoje, si ia ka marrë këngës!

JERA – Të duan shumë.

SAIMIRI – Megjithatë diçka mungon, që gëzimi të quhet i plotë. Mua babai, ty që të dy prindërit... Babait tim, me siguri, sonte do t’i kishin rrëshqitur lotët faqeve, do të ngrinte gotën e ta ndeshte me ty, me mua, me të gjithë. Edhe me nipçen e vogël!

JERA – Prindërit e mi duhej të vinin. Nuk ma kishte marrë mendja, se do të mungonin sonte. Sidomos babai!

SAIMIRI – Mëria paska qënë më e gjatë, se ç’kisha menduar dhe më e fortë!

JERA – Do të vijnë një ditë...

SAIMIRI – Më shumë e kam me veten...Ç’do gjë do të mbyllej dhe do të harrohej në kushte të tjera, sikur unë...

JERA – Mos e zë në gojë! Ti je i mrekullueshëm!

SAIMIRI – Jo, Jera, duhet ta kujtoj gjithmonë...

JERA – Si diçka të huaj...

SAIMIRI – Si diçka, që s’duhet t’i ndodhë askujt, se hija e fajit qënka shumë e rëndë!..

fund

Shtator 1985 – shkurt 1986

Premiera e shfaqjes në Teatrin “Migjeni” Shkodër”, 11 dhjetor 1987.